

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: PAKR 145/2014

(Pkr nr. 53/2013 Gj/Th Gjilan)

Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarës së EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova, kryetare e dhe gjyqtare raportuese, gjyqtarit të EULEX-it Willem Brouwer dhe gjyqtarës kosovare Fllanza Kadiu, si anëtarë të kolegjit, me ndihmën e këshilltares ligjore të EULEX-it Vjollca Kroci-Gerxhaliu, e cila vepron në cilësinë e procesmbajtëses dhe në seanca të hapura më 17 prill 2015 dhe 15 maj 2015;

Të pandehurit:

1. **V.J.**, emri i të atit xxx, mashkull, i lindur më datën xxx në xxx, komuna e xxx, vendbanimi aktual xxx
2. **S.J.**, emri i të atit xxx, mashkull, i lindur më datën xxx në xxx, vendbanimi i tanishëm në xxx
3. **G.L.**, emri i të atit xx mashkull, i lindur më datën xxx në xxx, komuna e xxx, xxx, me vendbanim aktual në xxx
4. **G.Xh.**, emri i të atit xxx, mashkull, i lindur më xxx, në xxx, komuna xxx, xxx;
5. **Q.R.**, emri i të atit xxx, mashkull, i lindur më xxx në xxx, me vendbanim të tanishëm xxx, komuna xxx;
6. **M.A.**, emri i të atit xxx, mashkull, i lindur më datën xxx në xxx, me vendbanim të tanishëm në xxx;
7. **S.S.**, emri i të atit xxx, mashkull, i lindur më xxx në xxx, komuna e xxx, me vendbanim në xxx, komuna xxx;
8. **E.M.**, mashkull, i lindur më datën xxx në xxx, me vendbanimi aktual në xxx, komuna e xxx;
9. **A.Z.**, emri i të atit xxx, mashkull, i lindur më datën xxx në xxx, me vendbanimi të tanishëm në xxx;
10. **J.Sh.**, emri i të atit xxx, mashkull, xxx në xxx, aktualisht me vendbanim në xxx

të akuzuar me aktakuzën PPS nr. 56/12 të datës 12 shkurt 2013 dhe të shpallur fajtor për këto vepra penale:

1. **Kryerja e terrorizmit**, neni 109 (1.10) dhe neni 110 (1) i Kodit Penal të Kosovës (tash e tutje në tekst: KPK) aktualisht e dënueshme me nenin 135(1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tash e tutje në tekst: KPRK);
2. **Organizimi në grup terrorist**, neni 113 (1) i KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 143 (1) të KPRK-së;
3. **Pjesëmarrja në grup terrorist**, në kundërshtim me nenin 113 (3) të KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 143 (2) të KPRK-së;
4. **Mbajtja në kontroll dhe në posedim të paautorizuar të armëve**, neni 328 i KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 374 të KPRK-së;

5. **Furnizimi dhe shitja e paautorizuar e armëve**, e paraparë dhe e dënueshme me nenin 327 të KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 372 të KPRK-së;
6. **Përdorimi i armëve**, e paraparë dhe e dënueshme me nenin 375 të KPRK-së;

duke vendosur përkitazi me ankesat në vijim të parashtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Gjilanit PKR nr. 53/13 të datës 16 tetor 2013:

1. **Ankesa e mbrojtësit Murat Demolli në emër të të pandehurit V.J. dhe ankesa e vet të pandehurit, të dyja të parashtruara më 4 shkurt 2014;**
2. **Ankesa e mbrojtësit Ramiz Sylejmani në emër të të pandehurit S.J., e parashtruar më 28 janar 2014;**
3. **Ankesa e mbrojtësit Shemsedin Piraj në emër të të pandehurit G.L., e parashtruar më 24 janar 2014;**
4. **Ankesa e mbrojtësit Sherif Sherifi në emër të të pandehurit G.Xh., e parashtruar më 29 janar 2014, dhe ankesa e të pandehurit e parashtruar më 6 shkurt 2015;**
5. **Ankesa e mbrojtësit Gafur Elshani në emër të të pandehurit Q.R., e parashtruar me postë më 29 janar 2014 dhe e vulosur në shkrimoren e gjykatës më 31 janar 2014;**
6. **Ankesa e mbrojtësit Mustafe Musa në emër të të pandehurit M.A., e parashtruar më 27 janar 2014;**
7. **Ankesa e mbrojtësit Destan Rukiqi për të pandehurin S.S., e parashtruar me postë më 29 janar 2014, e vulosur në shkrimoren e gjykatës më 31 janar 2014;**
8. **Ankesa e mbrojtësit Xhymshiti Shymshiti për të pandehurin E.M., e parashtruar në emër të të pandehurit më 27 janar 2014;**
9. **Ankesa e mbrojtësit Halit Azemi për të pandehurin A.Z., e parashtruar më 20 janar 2015;**
10. **Ankesa e mbrojtëses Lumnije Azemi për të pandehurin J.Sh., e parashtruar më 20 janar 2015.**

pas marrjes parasysh të përgjigjes së prokurorit special të EULEX-it e parashtruar më 13 shkurt 2014 ndaj ankesave të ushtruar në emër të të pandehurve si edhe propozimin e prokurorit të apelit të shtetit të Kosovës me numër PPA/I-KTZH/I.nr. 156/14 i paraqitur më 27 mars 2014,

pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit më 17 prill 2015, 15 maj 2015 dhe 27 maj 2015,

në përputhje me nenin 398 të KPPRK-së,

merr këtë

AKTGJYKIM

I GJYKATËS SË APELIT

- I. **Refuzohen si të pabaza ankesat e avokatëve përkatës mbrojtës të të akuzuarve V.J., S.J., G.L., G.Xh., M.A., S.S., E.M., A.Z. dhe J.Sh. si edhe ankesat e parashtruar personalisht nga të pandehurit V.J. dhe G.Xh. kundër aktgjykimit të lëshuar nga Gjykata Themelore e Gjilanit PKR nr. 53/13 të datës 16 tetor 2013;**
- II. **Pjesërisht pranohet ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit Q.R.. Aktgjykimi i lëshuar nga Gjykata Themelore e Gjilanit PKR nr. 53/13, i datës 16 tetor 2013, ndryshohet me sa vijon:**

- Sipas nenit 75 (1.2) të KPRK-së, të pandehurit Q.R. i shqiptohet ky dënim:
- Dënimi për veprën penale të kryerjes së terrorizmit sipas nenit 136 (1) lidhur me nenin 135 (1.10) të KPRK-së ndryshohet nga 5 (pesë) vjet në 3 (tre) vjet burgim. Duke pasur në konsideratë dënimin prej 2 (dy) vjet burgim të shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë për veprën penale të pjesëmarrjes në grup terrorist sipas nenit 113 (3) të KPK-së, dënimi unik ndryshohet në 4 (katër) vjet burgim.
- Refuzohet si e pabazë pjesa tjetër e ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit Q.R. kurse vërtetohet pjesa tjetër e aktgjykimit të lëshuar nga Gjykata Themelore e Gjilanit PKR nr. 53/13, i datës 16 tetor 2013.

III. Aktgjykimi i lëshuar nga Gjykata Themelore e Gjilanit PKR nr. 53/13 i datës 16 tetor 2013 lidhur me të pandehurit V.J., S.J., G.Xh. dhe E.M. ndryshohet *ex officio* me sa vijon:

1. I pandehuri V.J.:

SHPALLET FAJTOR

- a) Për (pika një) kryerje të terrorizmit, në kundërshtim me nenin 136 (1) lidhur me nenin 135 (1.10) të KPRK-së sepse është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se:
- I pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të grupit të vetëquajtur terrorist të njohur si ‘Lëvizja për liri’ me qëllim që padrejtësisht ta detyrojë Qeverinë e Republikës së Serbisë për t’i pushuar aktivitetet policore në regjionin e Bujanovcit, padrejtësisht t’i detyrojë pjesëtarët shqiptarë të policisë serbe që t’i lëshojnë vendet e tyre të punës dhe padrejtësisht ta detyrojë ‘bashkësinë ndërkombëtare’ të dërgojë forca paqeruajtëse në rajon; ai ka pasur në posedim dhe kontroll të kundërligjshëm një numër të pacaktuar të armëve (përfshirë këtu pushkë, mitraloz dhe raketahedhës) të cilat ishin në dispozicion të grupit terrorist “Lëvizja për liri” në bashkëkryerje me G.Xh.n, G.L., S.J.n, A.Z.n, E.M.n, S.S.n, M.A.n, Q.R.n, në një vend të paidentifikuar, duke filluar, më së voni, nga prill 2012 deri më 1 korrik 2012;
- b) Për (pika dy) organizim të grupit terrorist, sipas nenit 113 (1) të KPK-së, sepse është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se:
- I pandehuri, ka organizuar dhe drejtuar një grup të vetëquajtur terrorist të njohur si ‘Lëvizja për liri’ duke furnizuar me armatim, uniforma dhe pajisje të tjera të nevojshme aktivitetet e grupit, ka vendosur cilat akte duhet të kryhen nga grupi, ka vendosur kur, ku dhe nga kush do të kryhen aktet duke marrë pjesë personalisht, në së paku, një sulm të kryer nga grupi të përshkruara më sipër, duke përpiluar objektivat politike të grupit përfshirë këtu deklaratimet për përgjegjësi për sulmet e kryera nga grupi. Aktivitetet janë kryer në një vend të paidentifikuar, duke filluar, së më së voni, nga prill 2012 deri më 1 korrik 2012;

- c) **Akuza e mbajtjes në kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve**, neni 328 i KPK-së aktualisht e dënueshme me nenin 374 të KPRK-së kundër të pandehurit V.J., refuzohet sipas nenit 363 (1.1) të KPK, sepse prokurori e ka tërhequr akuzën.

Për këtë arsye, i pandehuri V.J.

DËNOHET

- **Për veprën penale të përshkruar në pikën një: kryerja e terrorizmit, sipas nenit 136 (1) lidhur me nenin 135 (1.10) të KPRK-së me 5 (pesë) vjet burgim;**
- **Për veprën penale të përshkruar në pikën dy: organizimi në grup terrorist, sipas nenit 113 (1) të KPK-së me 7 (shtatë) vjet burgim dhe gjobë në shumën prej 1000 (një mijë) euro bazuar në nenin 39 (1) dhe (2) të KPK-së për tu paguar jo më vonë se 3 (tre) muaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.**
- **Në bazë të nenit 71 (1) (2) pika 2 të KPK-së ndaj të pandehurit shqiptohet dënimi unik prej 8 vjet burgim. Sipas nenit 365 (1) 5) të KPPK-së në dënim llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim; i pandehuri lirohet nga kompensimi i shpenzimeve të procedurës penale në përputhshmëri me nenin 453 (4) të KPPK-së.**

2. I pandehuri S.J.:

SHPALLET FAJTOR

- a) **Për (pika një) kryerje të terrorizmit, në kundërshtim me nenin 136 (1) lidhur me nenin 135 (1.10) të KPRK-së** sepse është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se:
- I pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të grupit të vetëquajtur terrorist të njohur si ‘Lëvizja për liri’ me qëllim që padrejtësisht ta detyrojë Qeverinë e Republikës së Serbisë për t’i pushuar aktivitetet policore në regjionin e Bujanovcit, padrejtësisht t’i detyrojë pjesëtarët shqiptarë të policisë serbe që t’i lëshojnë vendet e tyre të punës dhe padrejtësisht ta detyrojë ‘bashkësinë ndërkombëtare’ të dërgojë forca paqeruajtëse në rajon; ai ka pasur në posedim dhe kontroll të kundërligjshëm një numër të pacaktuar të armëve (përfshirë këtu pushkë, mitraloz dhe raketahedhës) të cilat ishin në dispozicion të grupit terrorist “Lëvizja për liri” në bashkëkryerje me V.J., E.M., G.L., A.Z., G.Xh., S.S., M.A., Q.R. në një vend të paidentifikuar duke filluar më së voni, nga prill 2012 deri më 16 tetor 2012.
- b) **Për (pika dy) pjesëmarrje në grup terrorist në kundërshtim me nenin 113 (3) të KPK-së** sepse është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se:
- I pandehuri, në bashkëpunim me V.J.n, E.M.n, G. L., A.Z.n, G.Xh., S.S.n, M.A. dhe Q.R., ka marrë pjesë aktivisht në një grup të vetëquajtur terrorist të njohur si

‘Lëvizja për liri’ duke përpiluar deklarime për përgjegjësi, duke kërkuar armatim, duke i kryer veprat e përshkruara më lart, dhe përveç këtyre, duke e vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e tij. Aktivitetet janë zhvilluar në një vend të pidentifikuar në Kosovë duke filluar, më së voni, nga prill 2012 deri më 6 tetor 2012, dhe

- c) Akuza e mbajtjes në kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve**, neni 328 i KPK-së aktualisht e dënueshme me nenin 374 të KPRK-së kundër të pandehurit S.J., refuzohet sipas nenit 363 (1.1) të KPPK-së, sepse prokurori e ka tërhequr akuzën.

Për këtë arsye, i pandehuri S.J.

DËNOHET

- **Për veprën penale të përshkruar në pikën një: kryerja e terrorizmit, sipas nenit 136 (1) lidhur me nenin 135 (1.10) të KPRK-së me 5 (pesë) vjet burgim;**
- **Për veprën penale të përshkruar në pikën dy: pjesëmarrja në grup terrorist në kundërshtim me nenin 113 (3) të KPK-së, me 4 (katër) vjet burgim;**
- **Në bazë të nenit 71 (1) (2) pika 2 të KPK-së, ndaj të pandehurit shqiptohet dënimi unik prej 6 (gjashtë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim. Në dënim llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim; i pandehuri lirohet nga kompensimi i shpenzimeve të procedurës penale në përputhshmëri me nenin 453 (4) të KPPK-së.**

3. I pandehuri G.Xh.:

SHPALLET FAJTOR

- a) Për (pika një) kryerje të terrorizmit, në kundërshtim me nenin 136 (1) lidhur me nenin 135 (1.10) të KPRK-së** sepse është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se:
- I pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të grupit të vetëquajtur terrorist të njohur si ‘Lëvizja për liri’ me qëllim që padrejtësisht ta detyrojë Qeverinë e Republikës së Serbisë për t’i pushuar aktivitetet policore në regionin e Bujanovcit, padrejtësisht t’i detyrojë pjesëtarët shqiptarë të policisë serbe që t’i lëshojnë vendet e tyre të punës dhe padrejtësisht ta detyrojë ‘bashkësinë ndërkombëtare’ të dërgojë forca paqeruajtëse në rajon; ai ka pasur në posedim dhe kontroll të kundërligjshëm një numër të pacaktuar të armëve (përfshirë këtu pushkë, mitraloz dhe raketahedhës) të cilat ishin në dispozicion të grupit terrorist “Lëvizja për liri” në bashkëkryerje me V.J., S.J., G. L., A.Z., E.M. S.S.n, M.A.n, Q.R.n në një vend të pidentifikuar duke filluar, më së voni, nga prill 2012 deri më 1 korrik 2012;

b) Për (pika dy) pjesëmarrje në një grup terrorist në kundërshtim me nenin 113 (3) të KPK-së sepse është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se:

- I pandehuri, në bashkëpunim me V.J.n, S.J.n, G.L., A.Z.n, E.M.n, S.S.n, M.A.n, Q.R.n, ka marrë pjesë aktivisht në një grup të vetëquajtur terrorist të njohur si ‘Lëvizja për liri’ duke kërkuar armatim, duke i kryer veprat e përshkuara më lart, dhe përveç këtyre, duke e vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e tij në një vend të paidentifikuar në Kosovë duke filluar, më së voni, nga prill 2012 deri më 1 korrik 2012;

Për këtë arsye i pandehuri G.Xh.

DËNOHET

- **Për veprën penale të përshkruar në pikën një: kryerja e terrorizmit, sipas nenit 136 (1) lidhur me nenin 135 (1.10) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, me 5 (pesë) vjet burgim;**
- **Për veprën penale të përshkruar në pikën dy: pjesëmarrja në një grup terrorist në kundërshtim me nenin 113 (3) të KPK-së, me 2 (dy) vjet burgim;**
- **Në bazë të nenit 71 (1) (2) pika 2 të KPK-së ndaj të pandehurit shqiptohet dënimi unik prej 5 (pesë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim. Në dënim llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim; i pandehuri lirohet nga kompensimi i shpenzimeve të procedurës penale në përputhshmëri me nenin 453 (4) të KPPK-së.**

4. I pandehuri E.M.:

SHPALLET FAJTOR

a) Për (pika një) kryerje të terrorizmit, në kundërshtim me nenin 136 (1) lidhur me nenin 135 (1.10) të Kodit Penal të Republikës së Kosovë sepse është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se:

- I pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të grupit të vetëquajtur terrorist të njohur si ‘Lëvizja për liri’ me qëllim që padrejtësisht ta detyrojë Qeverinë e Republikës së Serbisë për t’i pushuar aktivitetet policore në regjionin e Bujanovcit, padrejtësisht t’i detyrojë pjesëtarët shqiptarë të policisë serbe që t’i lëshojnë vendet e tyre të punës dhe padrejtësisht ta detyrojë ‘bashkësinë ndërkombëtare’ të dërgojë forca paqeruajtëse në rajon; ai ka pasur në posedim dhe kontroll të kundërligjshëm një numër të pacaktuar të armëve (përfshirë këtu pushkë, mitraloz dhe raketahedhës) të cilat ishin në dispozicion të grupit terrorist “Lëvizja për liri” në bashkëkryerje me V.J.n, S.J.n, G.L., A.Z.n, G.Xh.n, S.S.n, M.A. dhe Q.R.n në një vend të paidentifikuar duke filluar, më së voni, nga prill 2012 deri më 16 tetor 2012,

c) **Për (pika dy) pjesëmarrje në grup terrorist** në kundërshtim me nenin 113 (3) të KPK-së sepse është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se:

- I pandehuri, në bashkëpunim me V.J.n, S.J.n, G.L., A.Z.n, G.Xh.n, S.S.n, M.A. dhe Q.R.n ka marrë pjesë aktivisht në një grup të vetëquajtur terrorist të njohur si 'Lëvizja për liri' *inter alia* duke kërkuar armatim, duke e vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e tij dhe duke e kryer veprën penale të përshkruar më sipër një vend të paidentifikuar në Kosovë duke filluar, më së voni, nga prill 2012 deri më 16 tetor 2012;

Për këtë arsye i pandehuri E.M.:

DËNOHET

- **Për veprën penale të përshkruar në pikën një: kryerja e terrorizmit, sipas nenit 136 (1) lidhur me nenin 135 (1.10) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, me 5 (pesë) vjet burgim;**
 - **Për veprën penale të përshkruar në pikën dy: pjesëmarrja në grup terrorist në kundërshtim me nenin 113 (3) të KPK-së, me 2 (dy) vjet burgim;**
 - **Në bazë të nenit 71 (1) (2) pika 2 të KPK-së ndaj të pandehurit shqiptohet dënimi unik prej 5 (pesë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim. Në dënim llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim; i pandehuri lirohet nga kompensimi i shpenzimeve të procedurës penale në përputhshmëri me nenin 453 (4) të KPPK-së.**
- IV. Vërtetohet në tërësi aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Gjilanit PKR nr. 53/13 i datës 16 tetor 2013 sa u përket të pandehurve G.L., M.A., S.S., A.Z. dhe J.Sh..**

ARSYETIMI

1. Procedura e gjertanishme e lëndës

Prokurori Special i Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzën ndaj të gjithë të pandehurve më 20 shkurt 2013. Të pandehurit u akuzuan për këto vepra penale:

- **Kryerja e terrorizmit**, neni 109 (1.10) dhe neni 110 (1) i Kodit Penal të Kosovës, aktualisht e dënueshme me nenin 135(1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tash e tutje në tekst: KPRK);
- **Organizimi në grup terrorist**, neni 113 (1) i KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 143 (1) të KPRK-së;
- **Pjesëmarrja në grup terrorist**, në kundërshtim me nenin 113 (3) të KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 143 (2) të KPRK-së;
- **Mbajtja në kontroll dhe në posedim të paautorizuar të armëve**, neni 328 i KPK-së (i vjetri), aktualisht e dënueshme me nenin 374 të KPRK-së;
- **Furnizimi dhe shitja e paautorizuar e armëve**, e paraparë dhe e dënueshme me nenin 327 të Kodit Penal të Kosovës, aktualisht e dënueshme me nenin 372 të KPRK-së
- **Përdorimi i armëve**, e paraparë dhe e dënueshme me nenin 375 të KPRK-së;

Shqyrtimi fillestar është mbajtur në përputhje me nenin 245 të Kodit të Procedurës Penale Nr. 04/L-123. Asnjëri nga të pandehurit nuk e ka pranuar fajësinë. Shqyrtimi i dytë është mbajtur më 14 prill 2013.

Më pas lënda ka vazhduar në shqyrtimin gjyqësor. Seanca e parë e shqyrtimi gjyqësor është mbajtur më 25 qershor 2013. Ndërsa 11 (njëmbëdhjetë) seanca të gjykimit janë mbajtur gjatë këtyre datave: 25 qershor 2013, 26 qershor 2013, 27 qershor 2013, 22 korrik 2013, 23 korrik 2013, 24 korrik 2013, 26 korrik 2013, 19 gusht 2013, 11 shtator 2013 dhe 26 shtator 2013.

Aktgjykimi (tash e tutje në tekst: aktgjykimi i kundërshtuar) është shpallur më 16 tetor 2013.

Aktgjykimi i ankimuar

Me këtë aktgjykim (tash e tutje në tekst: aktgjykimi i kundërshtuar) të pandehurit janë shpallur fajtor përtej dyshimit të arsyeshëm, ashtu sikurse janë akuzuar edhe me aktakuzë, si në vazhdim:

a) I pandehuri V.J.:

Kryerja e terrorizmit, neni 109 (1.10) dhe neni 110 (1) i Kodit Penal të Kosovës (i vjetri) aktualisht e dënueshme me nenin 135(1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sepse i pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të grupit të vetëquajtur terrorist të njohur si ‘Lëvizja për liri’ me qëllim që padrejtësisht ta detyrojë Qeverinë e Republikës së Serbisë për t’i pushuar aktivitetet policore në regjionin e Bujanovcit, padrejtësisht t’i detyrojë pjesëtarët shqiptarë të policisë serbe që t’i lëshojnë vendet e tyre të punës dhe padrejtësisht ta detyrojë ‘bashkësinë ndërkombëtare’ të dërgojë forca paqeruajtëse në rajon; ai ka marrë pjesë në një sulm që dëmtoi kontenierin e policisë kufitare serbe në Bujanovc dhe i shkaktoi policit serb B.M.lëndime të lehta trupore duke shtënë me armë të ndryshme, që të gjitha në posedim dhe përdorim të kundërligjshëm, një numër të pacaktuar të fishekëve me kalibër të ndryshëm (sido që të jetë, më shumë se 100) në bashkëkryerje me G.Xh.n dhe E.M.n; sulmi ka ndodhur në Dobrosin më 28 qershor 2012 rreth orës 04:00;

Organizimi në grup terrorist, neni 113 (1) i KPK-së (i vjetri), aktualisht e dënueshme me nenin 143 (1) të KPRK-së sepse i pandehuri ka organizuar dhe drejtuar një grup të vetëquajtur terrorist të njohur si ‘Lëvizja për liri’ duke furnizuar me armatim, uniforma dhe pajisje të tjera të nevojshme aktivitetet e grupit, duke vendosur cilat akte duhet të kryhen nga grupi, duke vendosur kur, ku dhe nga kush do të kryhen aktet e duke marrë pjesë

personalisht, në së paku, një sulm të kryer nga grupi i përshkruar më sipër, duke përpiluar synimet politike të grupit përfshirë këtu deklaratimet për përgjegjësi për sulmet e kryera nga grupi. Aktivitetet janë kryer në një vend të paidentifikuar duke filluar, së paku, nga prill 2012 deri më 1 korrik 2012; **Mbajtja në kontroll dhe në posedim të paautorizuar të armëve**, neni 328 i KPK-së (i vjetri), aktualisht e dënueshme me nenin 374 të KPRK-së sepse i pandehuri në mënyrë të kundërligjshme ka pasur në posedim armatim të rëndë në dispozicion të grupit terrorist “Lëvizja për liri” në bashkëkryerje me bashkë të pandehurit G.Xh., G.L., S.J., A.Z., E.M., S.S., M.A., Q.R.;

b) I pandehuri S.J.

Kryerja e terrorizmit, neni 109 (1.10) dhe neni 110 (1) i Kodit Penal të Kosovës (i vjetri) aktualisht e dënueshme me nenin 135(1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sepse i pandehuri në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të grupit të vetëquajtur terrorist të njohur si ‘Lëvizja për liri’ me qëllim që padrejtësisht ta detyrojë Qeverinë e Republikës së Serbisë për t’i pushuar aktivitetet policore në regjionin e Bujanovcit, padrejtësisht t’i detyrojë pjesëtarët shqiptarë të policisë serbe që t’i lëshojnë vendet e tyre të punës dhe padrejtësisht ta detyrojë ‘bashkësinë ndërkombëtare’ të dërgojë forca paqeruajtëse në rajon, ka marrë pjesë në një sulm që dëmtoi kontenierin e policisë kufitare serbe në Bujanovc duke shtënë me armë të ndryshme, që të gjitha në posedim dhe përdorim të kundërligjshëm, një numër të pacaktuar të fishekëve me kalibër të ndryshëm e në bashkëpunim me E.M.n dhe një numër të paidentifikuar të kryerësve të tjerë. Sulmi ka ndodhur në (komuna e Gjilanit)¹ më 7 tetor 2012 rreth orës 21:35 dhe sepse ai ka pasur në posedim dhe kontroll të kundërligjshëm një numër të pacaktuar të armëve (përfshirë këtu pushkë, mitraloz dhe raketahedhës) të cilat ishin në dispozicion të grupit terrorist “Lëvizja për liri” në bashkëkryerje me V.J.n, E.M.n, G.L., A.Z.n, G.Xh.n, S.S.n, M.A., Q.R.n në një vend të paidentifikuar duke filluar, së paku, nga prill 2012 deri më 16 tetor 2012; **Pjesëmarrja në grup terrorist**, në kundërshtim me nenin 113 (3) të KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 143 (2) të KPRK-së, sepse i pandehuri, në bashkëkryerje me V.J.n, E.M.n, G.L., A.Z.n, G.Xh.n, S.S.n, M.A., Q.R.n ka marrë pjesë aktivisht në një grup të vetëquajtur terrorist të njohur si ‘Lëvizja për liri’, duke përpiluar deklaratime të përgjegjësive, duke kërkuar armatim, duke e kryer veprën penale të përshkruar më sipër dhe, përpos këtyre, duke e vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e tij. Aktivitetet kanë ndodhur në një vend të paidentifikuar në Kosovë duke filluar, së paku, nga prill 2012 deri më 6 tetor 2012 dhe **Mbajtja në kontroll dhe në posedim të paautorizuar të armëve**, neni 328 i KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 374 të KPRK-së;

c) I pandehuri G.L.

Kryerja e terrorizmit, neni 109 (1.10) dhe neni 110 (1) i Kodit Penal të Kosovës (i vjetri) aktualisht e dënueshme me nenin 135(1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sepse i pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të grupit të vetëquajtur terrorist të njohur si ‘Lëvizja për liri’ me qëllim që padrejtësisht ta detyrojë Qeverinë e Republikës së Serbisë për t’i pushuar aktivitetet policore në regjionin e Bujanovcit, padrejtësisht t’i detyrojë pjesëtarët shqiptarë të policisë serbe që t’i lëshojnë vendet e tyre të punës dhe padrejtësisht ta detyrojë ‘bashkësinë ndërkombëtare’ të dërgojë forca paqeruajtëse

në rajon; ai ka pasur në posedim dhe kontroll të kundërligjshëm një numër të pacaktuar të armëve (përfshirë këtu pushkë, mitraloz dhe raketahedhës) të cilat ishin në dispozicion të grupit terrorist “Lëvizja për liri” në bashkëkryerje me V.J.n, S.J.n, A.Z.n, Q.R.n, G.Xh.n, M.A.n, E.M.n, S.S.n, në një vend të paidentifikuar duke filluar, së paku, nga prill 2012 deri më 13 shkurt 2013; **Pjesëmarrja në grup terrorist**, në kundërshtim me nenin 113 (3) të KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 143 (2) të KPRK-së, sepse i pandehuri, në bashkëkryerje me V.J.n, S.J.n, A.Z.n, Q.R.n, G.Xh.n, M.A.n, E.M.n dhe S.S.n, ka marrë pjesë aktivisht në një grup të vetëquajtur terrorist të njohur si ‘Lëvizja për liri’, duke kryer sulme në instalimet e policisë serbe më 17 maj, 28 qershor dhe 7 tetor 2012, duke e vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e tij dhe duke i kryer veprat penale të përshkruara më sipër në një vend të paidentifikuar duke filluar, së paku, nga prill 2012 deri më 13 shkurt 2013.

d) **I pandehuri G.Xh.**

Kryerja e terrorizmit, neni 109 (1.10) dhe neni 110 (1) i Kodit Penal të Kosovës, aktualisht e dënueshme me nenin 135(1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sepse i pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të grupit të vetëquajtur terrorist të njohur si ‘Lëvizja për liri’ me qëllim që padrejtësisht ta detyrojë Qeverinë e Republikës së Serbisë për t’i pushuar aktivitetet policore në regjionin e Bujanovcit, padrejtësisht t’i detyrojë pjesëtarët shqiptarë të policisë serbe që t’i lëshojnë vendet e tyre të punës dhe padrejtësisht ta detyrojë ‘bashkësinë ndërkombëtare’ të dërgojë forca paqeruajtëse në rajon; ai ka marrë pjesë në një sulm që dëmtoi kontenierin e policisë kufitare serbe në Bujanovc dhe i shkaktoi policit serb B.M.lëndime të lehta trupore duke shtënë me armë të ndryshme, që të gjitha në posedim dhe përdorim të kundërligjshëm, një numër të pacaktuar të fishekëve me kalibër të ndryshëm (sido që të jetë, më shumë se 100) në bashkëkryerje me V.J.n dhe E.M.n në Dobrosin më 28 qershor 2012 rreth orës 04:00 dhe për shkak se ka pasur në posedim dhe kontroll të kundërligjshëm një numër të pacaktuar të armëve (përfshirë këtu pushkë, mitraloz dhe raketahedhës) të cilat ishin në dispozicion të grupit terrorist “Lëvizja për liri” në bashkëkryerje me V.J.n, S.J.n, G.L., A.Z.n, E.M.n, S.S.n, M.A.n, Q.R.n, në një vend të paidentifikuar, duke filluar, së paku, nga prill 2012 deri më 1 korrik 2012, **Pjesëmarrja në grup terrorist**, në kundërshtim me nenin 113 (3) të KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 143 (2) të KPRK-së, sepse i pandehuri, në bashkëkryerje me V.J.n, S.J.n, G.L., A.Z.n, E.M.n, S.S.n, M.A.n, Q.R.n ka marrë pjesë aktivisht në një grup terrorist të vetëquajtur si ‘Lëvizja për liri’, duke kërkuar armatim, duke i kryer veprat penale të përshkruara më sipër dhe, përpos këtyre, duke e vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e tij në një vend të paidentifikuar në Kosovë duke filluar, së paku, nga prill 2012 deri më 1 korrik 2012;

e) **I pandehuri Q.R.**

Kryerja e terrorizmit, neni 109 (1.10) dhe neni 110 (1) i Kodit Penal të Kosovës, aktualisht e dënueshme me nenin 135(1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sepse i pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të grupit të vetëquajtur terrorist të njohur si ‘Lëvizja për liri’ me qëllim që padrejtësisht ta detyrojë Qeverinë e Republikës së Serbisë për t’i pushuar aktivitetet policore në regjionin e Bujanovcit, padrejtësisht t’i detyrojë pjesëtarët shqiptarë të policisë serbe që t’i lëshojnë vendet e tyre të punës dhe padrejtësisht ta detyrojë ‘bashkësinë ndërkombëtare’ të dërgojë forca paqeruajtëse në rajon; ka mbajtur në posedim dhe kontroll të kundërligjshëm një numër të pacaktuar

armëve (përfshirë këtu pushkë, mitraloz dhe raketahedhës) të cilat ishin në dispozicion të grupit terrorist “Lëvizja për liri” në bashkëkryerje me V.J.n, S.J.n, G.L., A.Z.n, G.Xh.n, M.A.n, E.M.n, S.S.n, në një vend të paidentifikuar duke filluar, së paku, nga prill 2012 deri më 1 korrik 2012, **Pjesëmarrja në grup terrorist**, në kundërshtim me nenin 113 (3) të KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 143 (2) të KPRK-së, sepse i pandehuri, në bashkëkryerje me V.J.n, S.J.n, G.L., A.Z.n, G.Xh.n, M.A.n, E.M.n, S.S.n, ka marrë pjesë aktivisht në një grup terrorist të vetëquajtur si ‘Lëvizja për liri’ që ka kryer sulme në instalimet e policisë serbe më 17 maj, 28 qershor dhe 7 tetor 2012, duke e vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e tij dhe duke i kryer veprat penale të përshkruara më sipër në një vend të paidentifikuar duke filluar, së paku, nga prill 2012 deri më 1 korrik 2012, **Mbajtja në kontroll dhe në posedim të paautorizuar të armëve**, e paraparë dhe e dënueshme me nenin 328 të KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 374 të KPRK-së refuzohet për të pandehurin Q.R., në përputhje me nenin 363 (1.1) të KPP-së sepse prokurori e ka tërhequr akuzën;

f) I pandehuri M.A.:

Kryerja e terrorizmit, neni 109 (1.10) dhe neni 110 (1) i Kodit Penal të Kosovës, aktualisht e dënueshme me nenin 135(1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sepse i pandehuri I pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të grupit të vetëquajtur terrorist të njohur si ‘Lëvizja për liri’ me qëllim që padrejtësisht ta detyrojë Qeverinë e Republikës së Serbisë për t’i pushuar aktivitetet policore në regjionin e Bujanovcit, padrejtësisht t’i detyrojë pjesëtarët shqiptarë të policisë serbe që t’i lëshojnë vendet e tyre të punës dhe padrejtësisht ta detyrojë ‘bashkësinë ndërkombëtare’ të dërgojë forca paqeruajtëse në rajon ka pasur në posedim dhe kontroll të kundërligjshëm një numër të pacaktuar të armëve (përfshirë këtu pushkë, mitraloz dhe raketahedhës) të cilat ishin në dispozicion të grupit terrorist “Lëvizja për liri” në bashkëkryerje me V.J.n, S.J.n, G.L., A.Z.n, G.Xh.n, E.M.n, S.S.n, E.M.n, Q.R.n në një vend të paidentifikuar, duke filluar, së paku, nga prill 2012 deri më 1 korrik 2012, **Pjesëmarrja në grup terrorist**, në kundërshtim me nenin 113 (3) të KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 143 (2) të KPRK-së, sepse i pandehuri në bashkëpunim me V.J.n, S.J.n, G.L., A.Z.n, G.Xh.n, S.S.n, E.M.n dhe Q.R.n ka marrë pjesë aktivisht në një grup të vetëquajtur terrorist të njohur si ‘Lëvizja për liri’ i cili *inter alia*, ka kryer sulme në instalimet e policisë serbe më 17 maj, 28 qershor dhe 7 tetor 2012, duke e vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e tij dhe duke i kryer veprat penale të përshkruar më sipër në një vend të paidentifikuar duke filluar, së paku, nga prill 2012 deri më 1 korrik 2012;

g) I pandehuri S.S.

Kryerja e terrorizmit, neni 109 (1.10) dhe neni 110 (1) i Kodit Penal të Kosovës, aktualisht e dënueshme me nenin 135(1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sepse i pandehuri, në bashkëpunim me pjesëtarët e tjerë të grupit të vetëquajtur terrorist të njohur si ‘Lëvizja për liri’ me qëllim të që padrejtësisht ta detyrojë Qeverinë e Republikës së Serbisë për t’i pushuar aktivitetet policore në regjionin e Bujanovcit, padrejtësisht t’i detyrojë pjesëtarët shqiptarë të policisë serbe që t’i lëshojnë vendet e tyre të punës dhe padrejtësisht ta detyrojë ‘bashkësinë ndërkombëtare’ të dërgojë forca paqeruajtëse në rajon, ka poseduar dhe kontrolluar në mënyrë të paligjshme një numër të pacaktuar të armëve (përfshirë këtu pushkë, mitraloz dhe raketahedhës) të cilat ishin në dispozicion të grupit terrorist “Lëvizja për liri” në bashkëkryerje me V.J.n, S.J.n, G.L., A.Z.n, G.Xh.n, M.A.n, E.M.n dhe Q.R.n, në një vend të paidentifikuar duke filluar, së paku, nga prill 2012

deri më 16 tetor 2012, **Pjesëmarrja në grup terrorist**, në kundërshtim me nenin 113 (3) të KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 143 (2) të KPRK-së, sepse i pandehuri, në bashkëkryerje me V.J.n, S.J.n, G.L., A.Z.n, G.Xh.n, M.A.n, E.M.n dhe Q.R.n ka marrë pjesë aktivisht në një grup të vetëquajtur terrorist të njohur si ‘Lëvizja për liri’, i cili *inter alia* ka kryer sulme në instalimet e policisë serbe më 17 maj, 28 qershor dhe 7 tetor 2012, duke e vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e tij dhe duke i kryer veprat penale të përshkruar më sipër në një vend të paidentifikuar duke filluar, së paku, nga prill 2012 deri më 16 tetor 2012;

h) I pandehuri E.M.

Kryerja e terrorizmit, neni 109 (1.10) dhe neni 110 (1) i Kodit Penal të Kosovës, aktualisht e dënueshme me nenin 135(1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sepse i pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të grupit të vetëquajtur terrorist të njohur si ‘Lëvizja për liri’ me qëllim që padrejtësisht ta detyrojë Qeverinë e Republikës së Serbisë për t’i pushuar aktivitetet policore në regjionin e Bujanovcit, padrejtësisht t’i detyrojë pjesëtarët shqiptarë të policisë serbe që t’i lëshojnë vendet e tyre të punës dhe padrejtësisht ta detyrojë ‘bashkësinë ndërkombëtare’ të dërgojë forca paqeruajtëse në rajon; ai ka marrë pjesë në një sulm që dëmtoi kontenierin e policisë kufitare serbe në Bujanovc dhe i shkaktoi policit serb B.M.lëndime të lehta trupore duke shtënë me armë të ndryshme, që të gjitha në posedim dhe përdorim të kundërligjshëm, një numër të pacaktuar të fishekëve me kalibër të ndryshëm (sido që të jetë, më shumë se 100) në bashkëkryerje me V.J.n dhe G.Xh.n në Dobrosin (komuna e Gjilanit) më 28 qershor 2012 rreth orës 04:00; sepse ka marrë pjesë në një sulm që dëmtoi kontenierin e policisë kufitare serbe në Bujanovc duke shtënë me armë të ndryshme, që të gjitha në posedim dhe përdorim të kundërligjshëm, një numër të pacaktuar të fishekëve me kalibër të ndryshëm e në bashkëpunim me S.J.n dhe një numër të paidentifikuar të kryerësve të tjerë në Dobrosin (komuna e Gjilanit) më 7 tetor 2012 rreth orës 21:35 dhe për shkak se ka pasur në posedim dhe kontroll të kundërligjshëm një numër të pacaktuar të armëve (përfshirë këtu pushkë, mitraloz dhe raketahedhës) të cilat ishin në dispozicion të grupit terrorist “Lëvizja për liri” në bashkëkryerje me V.J.n, S.J.n, G.L., A.Z.n, G.Xh.n, S.S.n, M.A.n dhe Q.R.n, në një vend të paidentifikuar duke filluar, së paku, nga prill 2012 deri më 16 tetor 2012, **Pjesëmarrja në grup terrorist**, në kundërshtim me nenin 113 (3) të KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 143 (2) të KPRK-së, sepse i pandehuri, në bashkëkryerje me V.J.n, S.J.n, G.L., A.Z.n, G.Xh.n, S.S.n, M.A.n dhe Q.R.n ka marrë pjesë aktivisht në një grup terrorist të vetëquajtur si ‘Lëvizja për liri’, *inter alia* duke kërkuar armatim, duke e vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e tij dhe duke i kryer veprat penale të përshkruara më sipër në një vend të paidentifikuar në Kosovë duke filluar, së paku, nga prill 2012 deri më 16 tetor 2012;

i) I pandehuri A.Z.

Kryerja e terrorizmit, neni 109 (1.10) dhe neni 110 (1) i Kodit Penal të Kosovës, aktualisht e dënueshme me nenin 135(1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sepse i pandehuri, në bashkëpunim me pjesëtarët e tjerë të grupit të vetëquajtur terrorist të njohur si ‘Lëvizja për liri’ me qëllim që padrejtësisht ta detyrojë Qeverinë e Republikës së Serbisë për t’i pushuar aktivitetet policore në regjionin e Bujanovcit, padrejtësisht t’i detyrojë pjesëtarët shqiptarë të policisë serbe që t’i lëshojnë vendet e tyre të punës dhe padrejtësisht ta detyrojë ‘bashkësinë ndërkombëtare’ të dërgojë forca paqeruajtëse në rajon, ka poseduar dhe kontrolluar në mënyrë të paligjshme një numër të pacaktuar të

armëve (përfshirë këtu pushkë, mitraloz dhe raketahedhës) të cilat ishin në dispozicion të grupit terrorist “Lëvizja për liri” në bashkëkryerje me V.J.n, S.J.n, G.L., Qendrim Rexhajn, G.Xh.n, M.A., E.M.n dhe S.S.n në një vend të pidentifikuar, duke filluar, së paku, nga prill 2012 deri më 17 tetor 2012; **Pjesëmarrja në grup terrorist**, në kundërshtim me nenin 113 (3) të KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 143 (2) të KPRK-së, sepse i pandehuri, në bashkëkryerje me V.J.n, S.J.n, G.L., Qendrim Rexhajn, G.Xh.n, M.A., E.M.n dhe S.S.n, ka marrë pjesë aktivisht në një grup terrorist të vetëquajtur si ‘Lëvizja për liri’, *inter alia* ka kryer sulme në instalimet e policisë serbe më 17 maj, 28 qershor dhe 7 tetor 2012, duke e vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e tij dhe duke i kryer veprat penale të përshkruar më sipër në një vend të pidentifikuar duke filluar, së paku, nga prill 2012 deri më 17 tetor 2012.

j) I pandehuri J.Sh.

Furnizimi dhe shitja e paautorizuar e armëve, e paraparë dhe e dënueshme me nenin 327 të Kodit Penal të Kosovës, aktualisht e sanksionuar me nenin 372 të KPRK-së sepse i pandehuri pa autorizim, ka ndërmjetësuar dhe bërë një sërë transaksionesh për shitjen e armëve të zjarrit me kalibër të ndryshëm përfshirë këtu shitjen e armëve të pidentifikuara të përmendura në pikën 3 në një vend të pidentifikuar më 7 nëntor 2012, **Përdorimi i armëve**, e paraparë dhe e dënueshme me nenin 375 të KPRK-së, i pandehuri ka përdorur dhe shkrepur armën të cilën ai e kishte në posedim të paligjshëm dhe **Mbajtja në kontroll dhe në posedim të paautorizuar të armëve**, e paraparë dhe e dënueshme me nenin 328 të KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 374 të KPRK-së.

Të pandehurit u dënuan me sa vijon:

- a) I pandehuri V.J. u shpall fajtor për veprën penale të kryerjes së terrorizmit dhe organizimit në grupi terrorist dhe u dënua me dënim unik prej 9 vjet dhe gjobë në shumën prej 1000 (një mijë) euro, shumë e cila, bazuar në nenin 39 (1) dhe (2) të KPRK-së, duhet të paguhet jo më vonë se 3 (tre) muaj pas që aktgjykimi të merr formën e prerë;
- b) I pandehuri S.J. u shpall fajtor për veprën penale të kryerjes së terrorizmit dhe pjesëmarrjes në grup terrorist dhe u dënua me dënim unik prej 8 (tetë) vjet;
- c) I pandehuri G.L. u shpall fajtor për veprën penale të kryerjes së terrorizmit dhe pjesëmarrjes në grup terrorist dhe u dënua me dënim unik prej 5 vjet e 6 muaj burgim;
- d) I pandehuri G.Xh. u shpall fajtor për veprën penale të kryerjes së terrorizmit dhe pjesëmarrjes në grup terrorist dhe u dënua me dënim unik prej 6 vjet e 6 muaj burgim;
- e) I pandehuri Q.R. u shpall fajtor për veprën penale të kryerjes së terrorizmit dhe pjesëmarrjes në grup terrorist dhe u dënua me dënim unik prej 5 vjet e 6 muaj burgim;
- f) I pandehuri M.A. u shpall fajtor për veprën penale të kryerjes së terrorizmit dhe pjesëmarrjes në grup terrorist dhe u dënua me dënim unik prej 5 vjet e 6 muaj burgim;
- g) I pandehuri S.S. u shpall fajtor për veprën penale të kryerjes së terrorizmit dhe pjesëmarrjes në grup terrorist dhe u dënua me dënim unik prej 5 vjet e 6 muaj burgim;
- h) I pandehuri E.M. u shpall fajtor për veprën penale të kryerjes së terrorizmit dhe pjesëmarrjes në grup terrorist dhe u dënua me dënim unik prej 6 muaj burgim;
- i) I pandehuri A.Z. u shpall fajtor për veprën penale të kryerjes së terrorizmit dhe pjesëmarrjes në grup terrorist dhe u dënua me dënim unik prej 5 vjet e 6 muaj burgim;
- j) I pandehuri J.Sh. u shpall fajtor për veprat penale të furnizimit dhe shitjes së paautorizuar të armëve si edhe përdorimi i armëve dhe u dënua me 2 vjet e 2 muaj burgim.

Vepra penale e mbajtjes në kontroll dhe në posedim të paautorizuar të armëve, sipas nenit 328 të KPK-së aktualisht nën nenin 374 të KPRK-së ndaj të pandehurve V.J., S.J., Q.R. dhe J.Sh. është refuzuar sepse prokurori i ka tërhequr këto akuza bazuar në Ligjin për amnisti.

Koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet në dënim për të gjithë të pandehurit. Ata u liruan edhe nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale lidhur me akuzat të cilat janë konsideruar të bazuara. Kryetari i trupit gjykues ka nxjerrë një aktvendim të ndarë më 16 tetor 2013 mbi vazhdimin e paraburgimit kundër të pandehurve V.J., S.J., G.L., G.Xh. dhe E.M. derisa aktgjykimi të merr formën e prerë; e ka ndryshuar masën e arrestit shtëpiak me paraburgim ndaj të pandehurve Q.R., M.A., S.S. dhe A.Z. derisa aktgjykimi të merr formën e prerë; e ka ndryshuar masën e paraburgimit me masën e arrestit shtëpiak ndaj të pandehurit J.Sh. derisa aktgjykimi të merr formën e prerë.

Bazuar në parimin e ligjit më të favorshëm, nenin 3 të KPK-së, gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar ligjin material të KPRK-së si në vazhdim:

- a) Për veprën penale të kryerjes së terrorizmit, është zbatuar kodi i ri penal si kod më i favorshëm për të pandehurit;
- b) Për veprën penale të organizimit në grup terrorist, e cila vlen vetëm për të pandehurin V.J., është zbatuar kodi i mëparshëm penal si kod më i favorshëm për të pandehurin;
- c) Për veprën penale të pjesëmarrjes në grup terrorist, është zbatuar kodi i vjetër penal si kod më i favorshëm për të pandehurin;
- d) Për veprën penale të furnizimit dhe shitjes së paautorizuar të armëve e cila vlen vetëm për të pandehurin J.Sh., është zbatuar kodi i vjetër penal si kod më i favorshëm për të pandehurin;
- e) Për veprën penale të përdorimit të armëve e cila vlen vetëm për të pandehurin J.Sh., gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar dispozitat e nenit 375 të kodit të ri;
- f) Për veprën penale të mbajtjes në kontroll dhe në posedim të paautorizuar të armëve, prokurori e ka zbatuar Ligjin për amnisti (Ligji nr. 04/L-209) dhe i ka tërhequr akuzat për këta të pandehur: V.J., S.J., Q.R. dhe J.Sh..

Në aktgjykimin e ankimuar është zbatuar neni 64 i KPK-së me rastin e përcaktimit të dënimit për secilin të pandehur veç e veç duke i marrë parasysh edhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Më pas ky aktgjykim është ankimuar nga të pandehurit në instance të apelit nga mbrojtësit në emër të të pandehurve përkatës. Prokurori special nuk ka parashtruar ankesë ndaj aktgjykimit por ka paraqitur përgjigje ndaj ankesave të mbrojtësve.

2. Parashtrës të palëve

2.1 Ankesat e të pandehurit V.J.

Dy ankesa u parashtruan ndaras: njëra nga mbrojtësi Murat Demolli më 31 janar 2014 dhe tjetra nga vet i pandehuri më 4 shkurt 2014.

2.1.1 Pohimet e sjella nga mbrojtësi:

Shkelje esenciale e KPP-së, neni 384 (1) pika (1.8): Avokati mbrojtës pohon se aktgjykimi cenon nenin 384 (1) pikën (1.8) sepse ai bazohet në prova të papranueshme. Sipas këtij mbrojtësi, aktgjykimi është i pakuptueshëm dhe kontradiktor. Ai kundërshton dyshimin e bazuar duke pohuar se gjykata e ka vërtetuar dyshimin e bazuar vetëm sipas transkriptimeve të bisedave telefonike dhe fotografive. Ai e kundërshton cilësimin juridik të veprës penale.

- a) **Vërtetim i gabueshëm dhe jo i plotë i gjendjes faktike:** Mbrojtësi pohon se veprimet e ndërmarra ashtu sikurse janë specifikuar në dispozitivin e aktgjykimit nuk kanë qenë të provuara me asnjë provë. Nuk ka prova për t' vërtetuar elementet e veprës penale për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor. Prandaj në mungesë të provave gjykata e ka kthyer gjendjen faktik në dëm të të akuzuarit. Pohimi i prokurorit në pikën 2 të aktakuzës se i pandehuri V.J. ishte udhëheqës i organizmit të grupit terrorist nuk ka qenë i provuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. V.J. ishte udhëheqës i subjektit politik të quajtur "Lëvizja për liri" e cila kishte të bënte me zgjidhjen e çështjes së shqiptarëve me mjete politike në Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë.
- b) **Shkelja e ligjit penal:** Mbrojtësi pohon se po që se provat e lëndës, pohimet e mbrojtjes dhe dëshmitë e dëshmitarëve, do të shoshiteshin siç duhet, atëherë cilësimi juridik i veprës penale do të kishte formë të ndryshme nga ajo që ka dispozitivi në aktgjykimin e ankimuar.
- c) **Vendimi mbi sanksionin penal:** Mbrojtësi konsideron se dënimi unik prej 9 vjet është i lartë pasi që qëllimi i dënimit do të arrihej me masë më të butë. Ai paraqet se gjykata e shkallës së parë nuk i ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese të tilla si faktin që i pandehuri nuk e ka shkelur kurrë më parë ligjin, është student në master dhe se ka pasur sjellje korrekte në raport me gjykatën.

Ai i propozon Gjykatës së Apelit që ta pranojë ankesën dhe lëndën ta kthej mbrapa në rigjykim, ose që ta ndryshojë aktgjykimin duke shqiptuar një masë më të butë.

2.1.2 Pohimet e sjella nga i pandehuri V.J.:

I pandehuri V.J. e konsideron aktgjykimin të pabazë, të papërcaktuar, kontradiktor dhe të bazuar në hipotezë e që si i tillë cenon nenin 361 (1 dhe 2) dhe nenin 365 (1) si edhe Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut e miratuar në Romë si edhe Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut e miratuar në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (Rezoluta 217). Ai pohon se është dënuar padrejtësisht dhe kërkon nga Gjykata e Apelit zbatim të drejtë të ligjit. Ai pohon se nuk ka prova të cilat qojnë në konkluzionin e gjyqtarit se ai ishte detyruar nga ide ekstreme. Më tej ai pohon se gjyqtari gabimisht e ka përcaktuar përgjimin telefonik duke iu qasur atij në mënyrë jo analitike dhe jo profesionale e vetëm duke u mbështetur në mendimin e prokurorëve sikurse është shpjeguar në aktakuzë. Biseda telefonike ka qenë miqësore dhe nuk ka pasur përmbajtje inkriminuese. Për këtë arsye është shkelur neni 386 (1, 2, dhe 3) i KPPK-së.

2.2 Ankesa e mbrojtësit në emër të të pandehurit S.J.

Pohimet:

- a) **Shkelje esenciale të KPP-së, neni 384 (1) pika (1.8) – Aktgjykimi bazohet në prova të papranueshme:** Mbrojtësi pohon se nuk ka asnjë provë konkrete për ta provuar se të pandehurit e tjerë i kishin sulmuar pikat kufitare të kontrollit në kufirin në mes të Kosovës

dhe Serbisë diku në afërsi të fshatit Dobrosin. Nuk ka asnjë provë se i pandehuri i ka dëmtuar anekset në kufi. Asnjëherë nuk është provuar se të pandehurit kanë poseduar armë të caktuara; gjykata vetëm ka supozuar se ata kanë poseduar armë.

- b) Vërtetim i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike:** Mbrojtësi pohon se grupi “Lëvizja për liri” nuk është grup terrorist sikurse thuhet nga gjykata. I pandehuri e ka mohuar plotësisht angazhimin e tij të dhunshëm për ta zgjedhur çështjen e shqiptarëve të luginës së Preshevës. Akuzat bazohen vetëm në pohime pa i treguar provat konkrete për lëndën. Ai i propozon Gjykatës së Apelit që ta hedh poshtë në tërësi aktgjykimin e kundërshtuar, ose lëndën ta kthej në rigjykim.

2.3 Ankesa e mbrojtësit në emër të të pandehurit G.L.

Pohimet:

- a) Shkelje esenciale të KPP-së, neni 384 (1) pika (1.12) – Aktgjyrimi nuk është përpiluar në përputhje me nenin 370 të KPP-së:** Mbrojtësi pohon se dispozitivi i aktgjyimit është në kundërshtim me arsyetimin e vet. Dispozitivi nuk përmban veprime inkriminuese lidhur me të akuzuarin G.L. Faktet ligjore kanë përmbajtje të ndryshme nga ajo e thënë në dispozitiv.
- b) Shkelje e ligjit penal nga neni 385 (1) 1.4) të KPP-së:** Mbrojtësi pohon se është bërë shkelje absolute e ligjit penal në dëm të të akuzuarit pasi që përkufizimi i terrorizmit nuk është shoshitur në mënyrë më të zgjeruar. Sipas mbrojtësit, gjykata nuk iu ka referuar nenit 31 të KP-së kur ka pohuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale në bashkëkryerje me bashkëpunëtorët e tjerë në grup terrorist. Duke mos e zbatuar këtë nen, gjykata e shkallës së parë i ka shkelur dispozitat e KP-së.
- c) Vërtetim i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike:** Mbrojtësi ka pohuar se gjykata duhet të vendos faktet kyçe në mënyrë që plotësisht të nxjerr në shesh faktet ligjore. Deklaratat e dëshmitarëve nuk i tregojnë veprimet inkriminuese të të pandehurit G.L. Ai e mohon përfshirjen e G.L. në aktet e Dobrosinit. Vet i pandehuri e ka mohuar përfshirjen e tij dhe gjykata është dashur ta konfirmojë faktin. Avokati mbrojtës pohon se duke shqiptuar në dënim më të butë, do të arrihej edhe qëllimi i dënimit.

2.4 Ankesa e mbrojtësit në emër të të pandehurit G.Xh.

Dy ankesa janë parashtruar ndaras, e para nga mbrojtësi Sherif Sherifi më 29 janar 2014 dhe e dyta është ushtruar nga vet i pandehuri më 6 shkurt 2014.

2.4.1 Pohimet e mbrojtësit:

- a) Shkelje esencial të KPP-së,
b) Shkelje të kodit penal,
c) Vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe

d) Vendimi mbi dënimin

Ai paraqet se gjykata nuk i ka paraqitur faktet në mënyrë të qartë dhe nuk e ka vlerësuar saktësinë e provave kontradiktore. Ai më tej paraqet se arsyetimi i aktgjykimit, në lidhje me këtë të pandehur, ishte bazuar vetëm në raportin e policisë për masa të fshehta respektivisht për përgjime të telekomunikimeve e që nuk siguron dyshim të arsyeshëm se i pandehuri i ka kryer veprat penale për të cilat u dënua. I pandehuri nuk e ka pranuar se i ka kryer veprat penale. Në lidhje me dënimin, mbrojtësi pohon se edhe po të provohej përgjegjësia penale e të pandehurit, dënimi është shumë i lartë. Ai i propozon Gjykatës së Apelit që ta miratojë ankesën e tij si të bazuar dhe ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar ashtu që i pandehuri të shpallet i pafajshëm ose ta prish aktgjykimin e kundërshtuar dhe lëndën ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

2.4.2 Pohimet e të pandehurit G.Xh.:

Në ankesat e tij i pandehuri G.Xh. pohon se ekziston shkelje e procedurës. Ai nuk ka mundur të shtjellojë bisedat telefonike në mes të tij dhe të tjerëve e të cilat gjykata i konsideron relevante. Ai më tej pohon se arsyetimi i aktgjykimit është një kopjim-bashkëngjitje (ang.copy/paste) e aktakuzës. Ai pohon se shpreson që Gj/A nuk do t'i jap formën e prerë këtij aktgjykimi si të tillë.

2.5 Ankesa e mbrojtësit në emër të të pandehurit Q.R.:

Pohimet:

- a) **Shkelje esenciale të KPP-së:** Avokati mbrojtës pohon se në aktgjykim mungojnë elementet e veprave penale. Gjykata e shkallës së parë thelbësisht e ka ndryshuar gjendjen faktike të provave në dëm të të pandehurit. Dispozitivi është i paqartë dhe i pakuptueshëm e është edhe mjaft konfuz. Pikë së pari përkufizimi i veprës penale të terrorizmit nuk mund të definohet si veprime të të akuzuarit. Duke iu referuar fotografive në të cilat i pandehuri është parë me kallashnikov dhe bisedës në internet, gjykata i ka konsideruar këto të një rëndësie të veçantë. Veprimet e ndërmarra nga i pandehuri nuk kanë shkaktuar pasoja të një terroristi sikurse përcaktohet me ligj. Arsyetimi i aktgjykimit është në kundërshtim me provat e vërtetuara në shqyrtimin gjyqësor. Kjo e bën aktgjykimin e kundërshtuar të paqëndrueshëm dhe i njëjti duhet të anulohet.
- b) **Shkelje e ligjit penal:** Aktgjykimi i kundërshtuar nuk mbështetet me prova. Mbrojtësi pohon se në lëndën aktuale, assesi nuk mund të flitet për veprat penale të kryerjes së terrorizmit dhe pjesëmarrjes në një grup terrorist. Sipas mendimit të mbrojtësit, në shqyrtimi gjyqësor nuk është paraqitur e as konfirmuar ndonjë veprim i të pandehurit me të cilin do të justifikohet ekzistimi i veprave penale për të cilat ai është dënuar. Për këtë arsye i pandehuri është dashur që të lirohet nga akuzat.
- c) **Vërtetimi i gabueshëm dhe jo i plotë i gjendjes faktike:** Mbrojtësi pohon se në këtë lëndë gjendja faktike nuk është konstatuar siç duhet. Aktgjykimi është bazuar vetëm në paragjykime. Biseda e përgjuar telefonike e të pandehurit Q. tregon se ai nuk ka marrë pjesë në ndonjë veprim i cili do të cilësohej si akt terrorist. Nga biseda në mes të Q. dhe V., gjykata konsideron se V. ishte ofenduar që nuk kishte marrë pjesë në veprim. Gjykata

Themelore e ka konsideruar këtë si provë inkriminuese në vend se ta shfrytëzojë si rrethanë lehtësuese.

- d) **Vendimi mbi sanksionin penal:** Avokati mbrojtësi pohon se Gjykata Themelore e Gjilanit nuk e ka konsideruar si rrethanë lehtësuese moshën e re të të pandehurit, faktin se ai nuk ka qenë i dënuar më parë; ai është student i mjekësisë. Prandaj nëse gjykata vendos t'i mbështes gjetjet e Gjykatës Themelore atëherë duhet të shqiptojë një dënim më të butë. Ai i propozon Gjykatës së Apelit që ta miratojë ankesën, ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe ta lirojë të pandehurin Q.R. nga akuzat.

2.6 Ankesa e avokatit mbrojtës në emër të të pandehurit M.A.

Pohimet:

- a) **Shkelje esenciale të KPPRK-së:** Shkelja esenciale e KPPRK-së përbëhet nga fakti se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është në kundërshtim me arsyetimin e vet. Aktgjykimi nuk është përpiluar brenda afatit sikurse parashihet me nenin 369 (1) të KPPRK-së por aktgjykimi është dorëzuar pas 90 ditëve.
- b) **Vërtetimi i gabueshëm dhe jo i plotë i gjendjes faktike:** Ai pohon se bisedat e përgjuara telefonike nuk janë vlerësuar siç duhet. Më tej ai thekson se gjatë hetimeve dhe në shqyrtimin gjyqësor, nuk është vërtetuar fajësia e të akuzuarit për veprat penale për të cilat është ngarkuar me aktakuzë. Pohimet se të pandehurit me aktin e tyre i kanë detyruar pjesëtarët shqiptarë të policisë serbe që t'i lënë vendet e tyre të punës, nuk është vërtetuar asnjëherë. Asnjëri prej tyre nuk e ka lënë punën si rezultat i akteve të ndërmarra nga i pandehuri. Përgjimet telefonike nuk e vënë në pah përgatitjen e ndonjë sulmi të armatosur. Deklaratat e dëshmitarëve janë jo relevante pasi që asnjëri nuk i përshkruan veprimet inkriminuese të të pandehurit. Më tej ai pohon se ligji material është zbatuar gabimisht. Përkufizimi i terrorizmit përmban në vete frikësim për popullatën.
- c) **Vendimi mbi dënimin** është i rëndë. Mbrojtja parashtrohet se gjykata është dashur t'i marrë parasysh edhe rrethanat e tjera lehtësuese, d.m.th. faktin që i pandehuri është burrë i ndershëm dhe familjar, baba i dy fëmijëve të mitur. Prandaj edhe duke e shqiptuar ndaj tij një dënim më të butë, do të arrihej qëllimi i dënimit.

2.7 Ankesa e mbrojtësit në emër të të pandehurit S.S.

Pohimet:

- a) **Shkeljet esenciale të KPP-së, neni 384 i KPP-së:** Mbrojtësi deklaron se aktgjykimi i kundërshtuar është i kundërligjshëm, pa bazë ligjore për shkak të shkeljeve esenciale të nenit 384 (1) 1.12 si dhe paragrafit (2) të KPP-së. Aktgjykimi nuk është përpiluar në bazë të nenit 370 (7) të KPP-së. Gjykata nuk e ka vërtetuar saktësinë e provave kontradiktore. Faktet gjenden vetëm në tri fotografi të një të pandehuri në një vend të panjohur. Nuk është provuar as mbajtja në posedim dhe kontroll të një numri të pacaktuar të armëve. As "pjesëmarrja në grupin terrorist" e përcaktuar me nenin 113 të KPK-së nuk shkon përtej

dyshimit të arsyeshëm. “Pjesëmarrja aktive” është vërtetuar pasi elementet e veprës penale kërkojnë pjesëmarrje aktive në grupin terrorist. Dashja (dolus) nuk është gjetur në mënyrë kumulative, që e bën me të meta aktgjykimin e kundërshtuar.

Aktgjykimi i kundërshtuar është në kundërshtim me nenin 384 (1) 1.12) lidhur me nenin 370 (7) dhe 384 (2) të KPP-së, pasi që nuk përmban asnjë arsye për refuzimin e propozimit të mbrojtjes lidhur me ekspertizën e fotografive nga ana e ekspertit të pavarur.

b) Vërtetimi i gabueshëm dhe jo i plotë i gjendjes faktike, neni 386 i KPP-së: Avokati mbrojtës pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar drejt gjendjen faktike lidhur me veprat penale. Mbrojtja ka kontestuar vërtetësinë e këtyre fotografive. Biseda telefonike nuk është vlerësuar si duhet. Konkluzioni i gjykatës që i pandehuri është pjesëtar aktiv i grupit në fjalë është konkluzion i gabuar. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, V.J., në mes tjerash, deklaroi se nuk i kujtohet ku dhe kur ishte bërë fotoja me S.S.n. I pandehuri S.J. deklaroi se gjatë procedurës paraprake ai nuk e ka njohur S.S.n; atë e ka njohur vetëm pasi është ngritur aktakuza. Ai nuk është anëtar i Lëvizjes për liri. Avokati mbrojtës më tej i referohet deklaratës së M. A. dhe vetë S.S.t duke thënë se aktgjykimi mbështetet në gjendjen faktike të konfirmuar në kundërshtim me nenin 386 të KPP-së, prandaj i njëjti duhet të anulohet.

c) Shkelje e ligjit penal në dëm të të akuzuarit, neni 385 i KPK-së: Lidhur me veprën penale të kryerjes së terrorizmit, mbrojtësi gjithashtu deklaroi se elementet e kësaj vepre penale siç është “mbajtja e paligjshme në pronësi dhe në kontroll e numrit të pacaktuar të armëve ...” janë në kuadër të Ligjit mbi amnisti, prandaj i pandehuri duhet patjetër të lirohet. Ai më tej thekson se është e papranueshme që vepra penale e kryerjes së terrorizmit të bazohet vetëm në tri fotografi të bëra me armë në duar në kohë dhe vend të pidentifikuar . Provat në shqyrtimin gjyqësor nuk kanë treguar pjesëmarrje aktive të të pandehurit në grupin terrorist.

d) Vendimi mbi dënimin, neni 387 i KPK-së: Avokati mbrojtës parashtron se çfarëdo dënimi që caktohet ndaj të pandehurit S.S. është dënim i kundërligjshëm, pasi që veprimet e tija nuk përmbajnë elemente të veprës penale për të cilën gjykata e ka shpallur fajtor. Duke e shqiptuar dënimin, gjykata e shkallës së parë e ka shkelur nenin 73 të KP-së, pasi që gjykata e ka vërtetuar rrethanën rënduese për vendosmëri në përmbushjen e qëllimeve, mosrespektimin e sundimit të ligjit në kuptimin e gatishmërisë për ta shkatërruar apo destabilizuar strukturën e brishtë politike të Kosovës, etj. Mbrojtësi i propozon Gjykatës së Apelit që ta miratojë ankesën e tij.

2.8. Ankesa e mbrojtësit në emër të të pandehurit E.M.

Pohimet:

a) Shkelje esenciale të KPP-së, neni 384 (1) 1.8): Avokati mbrojtës deklaroi se aktakuza nuk i ka vërtetuar faktet dhe se gjykata e ka lejuar shkeljen duke shtjelluar faktet të cilat nuk janë konfirmuar gjatë seancave. Prokuroria nuk ka ofruar fakte ashtu siç është kërkuar me ligj lidhur me të pandehurin.

- b) Vërtetimi i gabueshëm dhe jo i plotë i gjendjes faktike, neni 386 (1.2.3) i KPP-së:** Në shqyrtimin gjyqësor, prokurori nuk e ka konfirmuar asnjë provë lidhur me aktet kriminale për të cilat i pandehuri u shpall fajtor. Prokurori nuk ka dhënë asnjë fakt lidhur me veprën penale të kryerjes së akteve terroriste në bashkëkryerje në grup pasi nuk është konfirmuar ekzistimi i grupit në fjalë sepse të pandehurit nuk kishin asnjë raport tjetër përveç miqësisë nga universiteti. Vetëm G.Xh. ishte i afërm i tij. Fotoja e E.M.t ishte bërë rastësisht kur ai i kishte bërë shoqëri S.J.t në Preshevë. Fotografitë dhe përgjimet telefonike nuk janë të mjaftueshme për ta shpallur fajtor E.M.n për akt terrorist pasi që kjo gjë nuk shkon përtej dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e këtyre akteve kriminale. Lidhur me përkufizimin e terrorizmit, avokati mbrojtës parashtroi se grupi dhe E.M. nuk kanë përfaqësuar rrezik për shtetin përkatësisht Republikën e Serbisë. Përgjegjësia penale lidhur me të pandehurin nuk është vërtetuar.
- c) Vendimi mbi sanksionin penal, neni 386 (1) i KPRK-së:** Avokati mbrojtës parashtroi se vendimi mbi sanksionin penal nuk ka qenë në përputhje me ligjin (avokati mbrojtësi i referohet gabimisht nenit 386 dhe 387 të KPRK-së) . Gjykata e ka mbështetur vendimin e saj në telefonatat e përgjuara, në fotografi, në gëzhoja të ndryshme dhe në deklaratat e palës së dëmtuar / policisë. Këto prova nuk janë konfirmuar në asnjërin seancë, prandaj sanksioni penal nuk ka bazë ligjore lidhur me të pandehurin E.M.. Sanksioni kriminal është i paqëndrueshëm dhe i padrejtë. Ai i propozon Gjykatës së Apelit që ta miratojë ankesën, ta anulojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe ta kthejë lëndën për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

2.9. Ankesa e avokatit mbrojtës në emër të të pandehurit A.Z.

Pohimet:

- a) Shkelje esenciale të KPP-së;**
- b) Vërtetimi i gabueshëm dhe jo i plotë i gjendjes faktike;**
- c) Shkelje të ligjit penal; dhe**
- d) Vendimi mbi sanksionin penal**

Avokati mbrojtës parashtroi se aktgjykimi është i bazuar në prova të papranueshme, zaten në prova që kanë të bëjnë me të tjerët dhe të përdorura kundër të pandehurit A.Z.. Me asnjë provë nuk provohet se i pandehuri i ka kryer veprat penale në fjalë për të cilat është shpallur fajtor. As aktakuza as aktgjykimi nuk i përmbajnë veprimet kriminale të ndërmarra nga i pandehuri. A.Z. nuk i njeh të pandehurit e tjerë përveç V.J.t, të cilin e njeh nga universiteti. Ai dhe V.J. kanë biseduar vetëm lidhur me provimet. Kjo mund të konfirmohet nga telefonata e datës 17 qershor 2012. Është konfiskuar një kompjuter i vëllait të tij. Nuk është gjetur asgjë që do ta inkriminonte atë. I pandehuri madje as nuk e dinte që ekzistonte grupi terrorist i Lëvizjes për liri. Grupi terrorist nuk mund të ekzistojë kur anëtarët e tij nuk e njohin njëri tjetrin. A. kurrë nuk është takuar me të pandehurit e tjerë derisa nuk është takuar me ta në seancën gjyqësore.

Lidhur me veprën kriminale të terrorizmit, avokati mbrojtës e sqaron domethënien e terrorizmit duke deklaruar se terrorizmi kuptohet si dhunë duke kryer sulme, duke vënë eksplozivë dhe duke vënë zjarre, helme të ndryshme kimike dhe biologjike, të cilat përfaqësojnë veprën penale me pasoja të jashtëzakonshme për jetën dhe shëndetin e njerëzve, me një rrezik serioz për civilët.

Ai më tej thekson se nuk ka fakte konkrete për të konstatuar se i akuzuar ka marrë pjesë apo ka asistuar. Aktakuza gabimisht e përmend se i pandehuri kishte pasur lloje të ndryshme të armëve përderisa asgjë nuk i ishte gjetur.

Dënimi është i pabazuar, prandaj ai i propozon Gjykatës së Apelit që ta anulojë aktgjykimin e shkallës së parë dhe ta kthejë lëndën në rigjykim apo ta ndryshojë aktgjykimin në mungesë të provave dhe ta lirojë të pandehurin A.Z. nga akuzat.

2.10. Ankesa e avokates mbrojtës në emër të të pandehurit J.Sh.

Pohimet:

- a) Shkelje esenciale të KPP-së;**
- b) Vërtetimi i gabueshëm dhe jo i plotë i gjendjes faktike;**
- c) Shkelja e ligjit penal; dhe**
- d) Vendimi mbi sanksionin penal**

Shkelja esenciale e KPP-së qëndron në faktin se nuk ekzistojnë prova të bazuara dhe relevante por vetëm një bisedë e rëndomtë e të akuzuarve.

Avokatja mbrojtëse në fjalë më tutje deklaron se: (citim)“Duke e pasur parasysh se i akuzuari është akuzuar dhe është duke u gjykuar për periudhën kohore maj – qershor 2012, përderisa është akuzuar dhe gjykohet me dispozitat ligjore të ligjit penal i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, prandaj ligji i ri zbatohet në mënyrë retroaktive, për shkak se çdo ligj pasi të hyjë në fuqi është ligj i zbatueshëm. Por në rastin konkret, zbatohen dispozitat ligjore të ligjit penal i cili ka hyrë në fuqi më 6 prill 2014, ligj ky i cili nuk parasheh dispozitën ligjore të përdorimit të armëve. Prandaj, nuk mund të zbatohen dispozitat e ligjit të ri; ato dispozita mund të zbatohen vetëm pasi të hyjë në fuqi ligji, dhe jo për periudhën paraprake”.

Ajo më tutje i referohet Ligjit mbi amnistinë duke deklaruar se ky ligj në mënyrë të qartë e thekson se posedimi i kundërligjshëm i armëve të zjarrit, në bazë të nenit 3, pikës 1.2.5 iu referohet personave të cilëve iu miratohet amnistia. Për këtë arsye, i pandehuri J.Sh. duhet të lirohet nga të gjitha akuzat në fjalë. Ajo më tej deklaron se nuk mund të akuzohet një person për të gjitha veprat penale në atë kapitull. Për këtë arsye, ajo konsideron aktgjykimin përjashtimor, abstrakt dhe të pabazë për shkak se nuk ka përshkrime të veprimeve konkrete, por bazohet vetëm në armë të paspecifikuara, në vende të paspecifikuara, në shitje të armëve të paspecifikuara, në kontroll, posedim dhe përdorim të paspecifikuar të armëve të paspecifikuara.

Lidhur me telefonatën, avokatja mbrojtëse deklaroi se telefonata ka qenë e rastësishme, abstrakte dhe e pakuptueshme. Ajo më tej thekson se duhet të konsiderohet fakti se asnjë armë nuk është gjetur përveç 20 plumbave të papërdorshëm dhe të ndryshkur të cilët kanë mbetur qysh nga koha e luftës, përderisa i pandehuri është dënues pikërisht në kapitullin që ka të bëjë me armët.

Avokatja mbrojtëse i propozon Gjykatës së Apelit që ta anulojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe ta kthejë lëndën në Gjykatën Themelore të Gjilanit për rigjykim, apo ta ndryshojë ashtu që ta lirojë të akuzuarin nga akuzat apo t'i shqiptojë masë më të butë.

3. Gjetjet e Gjykatës së Apelit

3.1 Çështje preliminare të procedurës

Kolegji i Gjykatës së Apelit ka mbajtur seancë për këtë lëndë më 17 prill 2015 dhe 15 maj 2015; edhe këshillimet i ka mbajtur më 17 prill 2015 dhe 15 maj 2015. Në seancën e këshillimit më 17 prill 2015, kolegji ka vendosur në lidhje me vuajtjen e dënimit ndaj të pandehurit J.Sh. sikurse është shpallur me aktgjykimin e ankimuar dhe për këtë ka lëshuar një aktvendim të ndarë.

3.2 Kompetenca e gjykatës dhe përbërja e kolegjit

Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur përkitazi me ankesat e palëve kundër aktgjyimit të shkallës së parë, në përputhje me nenet 17 dhe 18 të Ligjit mbi gjykatat (Ligji Nr. 03/L-199).

Kolegji i Gjykatës së Apelit është formuar në përputhje me nenin 19 (1) të Ligjit mbi gjykatat dhe nenin 3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë - Ligji nr. 03/L-053 i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-273, dhe i qartësuar përmes Marrëveshjes në mes të Shefit të EULEX-it në Kosovë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 18 qershor 2014.

Ligji i ndryshuar nr. 04/L-273 (i njohur në opinion edhe si Ligji Omnibus i EULEX-it) në nenin 1.A përcakton se cilat lëndë përbëjnë lëndë që janë në proces (në zhvillim e sipër) që janë në kompetencë të EULEX-it. Lënda aktuale në mënyrë të qartë përbën lëndë që është duke u zhvilluar sipas nenit 1A (1) të ligjit në fjalë. Hetimet në këtë lëndë janë iniciuar në 2012, aktgjykimi i shkallës së parë është nxjerr në shtator 2013 dhe lënda ka qenë në pritje pranë Gjykatës së Apelit që nga janari 2014.

Pas vërtetimit të kompetencës së EULEX-it për lëndën, çështja e radhës e cila ngritët nga kolegji është përbërja e kolegjit në një lëndë të EULEX-it e cila është në proces.

Sipas nenit 3.3 të Ligjit nr. 04/L-273 kolegjet për lëndë të cilat janë nën juridiksion të EULEX-it duhet të përbëhen në shumicë nga gjyqtarët kosovar përveç në rastet kur Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) vendos që kolegji duhet të jetë i përbërë në shumicë nga gjyqtarët e EULEX-it.

Kjo dispozitë dhe kusht për një vendim nga KGJK-ja sjellin nenin 2 të Marrëveshjes në mes të EULEX-t dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 18 qershor 2014. Përmes kësaj marrëveshje KGJK-ja ka vendosur se në të gjitha lëndët të cilat janë duke u zhvilluar, trupi gjykues do të përbëhet në shumicë nga gjyqtarët e EULEX-it dhe “do të vazhdojë me kolegje me gjyqtarë të EULEX-it në shumicë për vazhdimin e të gjitha fazave të gjykimit dhe pjesën tjetër të procedurës.” Përkufizimi “pjesa tjetër e procedurës” doemos duhet të lexohet si referim i qartë në procedurë me mjete juridike. Për këtë arsye kjo dispozitë vlen edhe për procedurën e apelit për ato lëndë të cilat janë në proces.

Sipas kësaj baze ligjore të sipër përmendur, në lëndën në fjalë, kolegji i apelit pra përbëhet në mënyrë korrekte nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar kosovar i Gjykatës së Apelit.

Në seancën e mbajtur më 17 prill 2015, i pandehuri S.J. ka paraqitur kundërshtim lidhur me pjesëmarrjen e kryetare së kolegjit Elka Filcheva-Ermenkova. Ai ka kërkuar përjashtimin e saj nga kolegji duke pohuar objektivitetin në bazë të shtetësisë së saj bullgare, duke pretenduar se origjina e saj bullgare (pra sllave) e bën atë të njëanshme ndaj të pandehurit dhe se ajo do të ndikohet në vendimin e saj - sipas fjalëve të të pandehurit - të bërë nga ‘Beogradi’. I pandehuri i referohet faktit të njohur nga ai se “gjyqtarët nga Evropa Juglindore janë të korruptuar’.

Ligjërisht kundërshtimi është përkufizuar sipas nenit 39.3 të Kodit të procedurës penale i cili parasheh arsyen për përjashtim të një gjyqtari për shkak të mos paraqitjes të rrethanave në përputhje me nenin 39 (1 dhe 2) *po aty*. Ndryshe nga domosdoshmëria e dispozitës së nenit 40 (1), *po aty*, e cila në mënyrë eksplicite dhe të pakushtëzuar kërkon përfshirjen e kryetarit të Gjykatës së Apelit në secilin rast të kundërshtimit për përjashtim, nën çdo rrethanë të përmendur në nenin 39 (1 dhe 2) *po aty*, hipoteza e nenit 40 (2) *po aty*, e lë këtë në zgjedhje të gjyqtarit i cili është subjekt i kundërshtimit për përjashtim, për të ose për të mos “konstatuar” nëse ekzistojnë rrethana të cilat do ta justifikonin përjashtimin. Në rastin në fjalë, gjyqtarja përkatëse dhe kolegji në tërësi është pajtuar se shtetësia bullgare e kryetares së kolegjit nuk kërkon zbatimin e nenit 39 (3) dhe nenit 40 (2) *po aty*, dhe se në këtë aspekt, kolegji nuk e ndërpreu procedurën e mëtejme sikurse ishte dëshira e të pandehurit.

Ligji i zbatueshëm i procedurës penale

Sipas nenit 540 të KPPK-së në fuqi nga 1 janar 2013, i njëjti kod është i zbatueshëm edhe në këtë lëndë.

Pranueshmëria e ankesave

- a) **Ankesa për të pandehurin V. J.:** Të pandehurit i është dorëzuar aktgjykimi më 21 janar 2014, avokatit të tij mbrojtës Murat Demolli më 17 janar 2014. Vet i pandehuri ka parashtruar ankesë më 4 shkurt 2014 dhe mbrojtësi Murat Demolli në emër të të pandehurit më 4 shkurt 2014. Të dyja ankesat janë dorëzuar me postë sikurse është provuar nga zarfi në shkresat e lëndës dhe janë vulosur në shkrimoren e gjykatës po të njëjtën ditë.

- b) **Ankesa për të pandehurin S.J.:** Aktgjykimi i është dorëzuar të pandehurit më 27 janar 2014, avokatit mbrojtës Ramiz Sylejmani më 15 janar 2014. Ankesa është parashtruar në emër të të pandehurit më 28 janar 2014, ashtu sikurse është vulosur edhe nga shkrimorja e gjykatës.
- c) **Ankesa për të pandehurin G.L.:** Aktgjykimi i është dorëzuar të pandehurit më 21 janar 2014, avokatit mbrojtës Shemsedin Piraj më 15 janar 2014. Ankesa është parashtruar nga avokati mbrojtës më 24 janar 2014 ashtu sikurse edhe është vulosur nga shkrimorja e gjykatës;
- d) **Ankesa për të pandehurin G.Xh.:** Aktgjykimi i është dorëzuar të pandehurit më 21 janar 2014, avokatit mbrojtës Sherif Sherifi më 15 janar 2014. Ankesa e parashtruar nga i pandehuri është vulosur më datë 06 shkurt 2014 dhe ankesa e avokatit mbrojtës e parashtruar në emër të të pandehurit 29 janar 2014 sikurse është vulosur në shkrimoren e gjykatës;
- e) **Ankesa për të pandehurin Q. R.:** Aktgjykimi i është dorëzuar të pandehurit më 15 janar 2014 kurse avokatit mbrojtës Gafur Elshani më 16 janar 2014. Ankesa është parashtruar në emër të pandehurit me postë më 29 janar 2014 dhe e vulosur në shkrimoren e gjykatës më 31 janar 2014;
- f) **Ankesa për të pandehurin M.A.:** Aktgjykimi i është dorëzuar të pandehurit më 21 janar 2014 ndërsa avokatit mbrojtës Mustafe Musa më 15 janar 2015. Ankesa është e parashtruar në emër të të pandehurit më 27 janar 2014 ashtu sikurse është vulosur nga shkrimorja a gjykatës;
- g) **Ankesa për të pandehurin S.S.:** Aktgjykimi i është dorëzuar të pandehurit më 21 janar 2014 dhe avokatit mbrojtës Destan Rukiqi më 15 janar 2014. Ankesa është parashtruar me postë në emër të të pandehurit më 29 janar 2014 dhe e vulosur në shkrimoren e gjykatës më 31 janar 2014.
- h) **Ankesa për të pandehurin E.M.:** Aktgjykimi i është dorëzuar të pandehurit më 24 janar 2014 kurse avokatit mbrojtës Xhymshiti Shymshiti më 15 janar 2014. Ankesa është parashtruar në emër të të pandehurit më 27 janar 2014 ashtu sikurse është vulosur nga shkrimorja e gjykatës;
- i) **Ankesa për të pandehurin J.Sh.:** Aktgjykimi i është dorëzuar të pandehurit më 22 janar 2014, avokates mbrojtëse Lumnije Azemi më 15 janar 2014. Ankesa është parashtruar në emër të të pandehurit më 20 janar 2014 ashtu sikurse është vulosur në shkrimoren e gjykatës;

Pra kolegji i apelit i konsideron të gjitha ankesat të parashtruara në kohë.

Çështje meritore të lëndës

Të gjitha ankesat përmbajnë se aktgjykimi i kundërshtuar është i pakuptueshëm dhe kontradiktor; shkelje sipas nenit 383 të KPP-së, respektivisht shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384 (1.8) të KPP-së, shkelje të ligjit penal, sipas nenit 385 të KPP-së, vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sipas nenit 386 të KPP-së dhe vendimi mbi sanksionin penal, sipas nenit 387 të KPP-së.

Të gjitha ankesat janë refuzuar. Gjykata *ex officio* e ka ndryshuar aktgjykimin e kundërshtuar në lidhje me dënimin e të pandehurve V.J., S.J., G.Xh. dhe E.M.. Ankesa e të pandehurit Q.R. pranohet pjesërisht në lidhje me vendimin mbi dënimin.

Gjykata e Apelit do të shqyrtojë të gjitha arsyet për ankesë të ngritura nga 10 të pandehurit dhe avokatët e tyre mbrojtës nën tituj të ndryshëm. Parashtruesit e ankesave ngritin disa kundërshtime të njëjta, prandaj të njëjtat do të shqyrtohen bashkërisht. Pohime të caktuara të të pandehurve të ndryshëm do të shqyrtohen individualisht. Kur të shqyrtojë ankesat nga të pandehurit individualisht, Gjykata e Apelit do të shqyrtojë edhe ankesat e parashtruar në emër të tyre nga avokatët e tyre mbrojtës dhe do të shqyrtojë bashkërisht pohimet e ngritura personalisht nga të pandehurit dhe nga mbrojtësit.

4. Shkelje të pohuara të dispozitave të procedurës penale – pranueshmëria e provave

Të pandehurit paraqesin shkelje të nenit 384 (1.8) të Kodit të procedurës penale respektivisht se aktgjykimi është i bazuar në prova të papranueshme. Të pandehurit nuk i përcaktojnë se cilat prova dhe për çfarë arsye të njëjtat do të ishin të papranueshme. Për arsye se mbrojtja nuk i referohet ndonjë prove të caktuar e cila, sipas tyre, nuk ka qenë e vlerësuar siç duhet, kolegji i Gjykatës së Apelit e shqyrton *ex officio* shkeljen e pohuar duke vepruar në përputhje me nenin 394 të KPP-së.

Sipas kodit të procedurës penale provat e papranueshme duhet të shqyrtohen në rastet kur ekziston shkelja e nenit 155 lidhur me pranueshmërinë e deklaratës të të pandehurve, nenit 128 lidhur me rrethanat kur deklarata është e papranueshme, nenit 249 (4) lidhur me provat e përjashtuara dhe nenit 111 të KPP-së mbi pranimin e provave nga hulumtimi i bërë. Kolegji i Gjykatës së Apelit i ka vlerësuar provat në shkresat e lëndës dhe në kuadër të kësaj nuk gjen asnjë veprim procedural me të cilën janë cenuar nenet e përmendura më sipër e që do të përbënte shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale.

Kolegji i apelit vëren se aktgjykimi është i bazuar në prova dokumentuese reale të cilat tregojnë pjesëmarrjen aktive të të pandehurve në akte kriminale për të cilat ata janë shpallur fajtor. Të gjitha këto prova janë të pranueshme dhe për këtë arsye konsiderohen të natyrës provuese.

Prandaj gjykata i hedh poshtë këto pohime si të pabaza.

- Shkelje e pohuar e nenit 384 (1.12) lidhur me nenin 370 se aktgjykimi i kundërshtuar është i pakuptueshëm dhe kontradiktor

Pohimet e ngritura nga të pandehurit V.J., G.L., G.Xh. (jo drejtpërsëdrejti por duke iu referuar dispozitivit sikurse “lë shumë për të dëshiruar”) Q.R., M.A., S.S.. Mbrojtësi i S.S.t e shtjellon në detaje se aktgjykimi është në kundërshtim me dispozitat e nenit 370 (7) *po aty* pasi që gjykata e

shkallës së parë nuk e ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte ajo i konsideron dhe nuk i konsideron të vërtetuara dhe se aktgjykimi përmban një arsyetim shumë të shkurtër lidhur me këtë të pandehur.

Kjo arsye e ankesës refuzohet si e pabazë. Gjykata e Apelit pajtohet se aktgjykimi nuk është shumë i detajuar. Megjithatë ai përmban elementet e kërkuara me ligj në nenin 384 (1.12) lidhur me nenin 370 *po aty*. I njëjti përmban një përshkrim të plotë të fakteve vendimtare dhe të kuptuarit e veprave të kryera penale të tilla si cilësimi juridik dhe në bazë të cilave fakte është shqiptuar dënimi. Gjykata Themelore e ka bërë një vlerësim të provave dhe i ka sqaruar arsyet për vendosjen e pikave të fakteve dhe ligjit, me përjashtim të përmendur më lartë në lidhje me katër të pandehurit V.J., S.J., Gazmend Xhemsiri dhe E.M. për të cilët gjykata do të jap një elaborim më poshtë në këtë vendim.

Nga aktgjykimi kuptohet se përveç J.Sh.t të gjithë të pandehurit janë shpallur fajtor për kryerjen e terrorizmit të paraparë me nenin 135 (1.10) të KPK-së në formë të posedimit dhe kontrollit të një numri të pacaktuar të armëve (përfshirë automatikë dhe raketahedhës) në mes të prill 2012 dhe 1 korrik 2012. Është kuptuar se V.J. është dënuar për organizim të një grupi terrorist dhe përveç Jatton Shabanit të gjithë të pandehurit e tjerë për pjesëmarrje në aktivitetet e të njëjtit grup (krimet në hipotezën përkatëse të nenit 143 të KPK-së, më parë e dënueshme sipas dispozitave përkatëse të nenit 113 të kodit të vjetër të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës. Katër të pandehurit V.J., S.J., G.Xh. dhe E.M. u shpallën fajtor dhe u dënuan po ashtu sipas cilësimit juridik nga neni 135 (1.10) të KPK-së për shkak të tri sulmeve të ndryshme ndaj kontenerit të policisë kufitare të Serbisë, për të cilën, gjykata do ta jap një elaborim më pas. Nga aktgjykimi po ashtu është e qartë se për cilat krime të përcaktuar siç duhet si fakte dhe me ligj, u dënua i pandehuri J.Sh..

Me përjashtim të katër të pandehurve të përmendur më sipër, Gjykata Themelore e ka bërë një vlerësim të drejtë të provave individualisht dhe për secilin të pandehur dhe ka shpjeguar tërësisht pjesëmarrjen e saktë të secilit prej tyre në krime të ndryshme në varësi të aktakuzës dhe vendimit.

Shkeljet e pohuara të nenit 7(2) të KPP-së (detyrimi i përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve) dhe neni 3 i KPP-së (parimi i prezumimit të pafajësisë)

Avokatët mbrojtës të të gjithë të pandehurve pajtohen se Gjykata Themelore nuk ka arritur t'i vlerësojë provat veç e veç dhe bashkërisht dhe nuk ka arritur për ta respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë. Padyshim mbrojtësit pohojnë se ka pasur shkelje substanciale të procedurës penale sipas nenit 384(2) të KPP-së.

Neni 7(2) i KPPK-së parasheh që “sipas dispozitave të parapara me këtë Kod, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia që marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij, dhe para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj t'i mundësojnë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të të pandehurit.”

Neni 3 i KPP-së parasheh parimin e prezumimit të pafajësisë së të pandehurit dhe parimin *in dubio pro reo*.

Kolegji nuk gjen asnjë shkelje të këtyre dispozitave në këtë lëndë.

Sa i përket nenit 7 (2) të KPP-së, nga analiza e cila gjendet në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar është e qartë se Gjykata Themelore e ka bërë një analizë të kujdesshme dhe të përpiktë të provave në lëndë. Gjykata Themelore ka qenë plotësisht në dijeni për kundërshtimet në mes të provave dhe të njëjtat i ka shqyrtuar.

Avokatët mbrojtës mundë apo mundë të mos pajtohen me konkluzionet e Gjykatës Themelore të nxjerra pas kryerjes së analizës së saj të provave. Megjithatë mbrojtja nuk mund të pohojë në mënyrë të arsyeshme se Gjykata Themelore nuk e ka përmbushur detyrimin e saj për t'i shqyrtuar provat me kujdes dhe me përkushtim maksimal profesional.

Për më tepër analiza e fakteve në shqyrtimin gjyqësor zbulon se trupi gjykues përgjatë tërë procedurës ka qenë i përkushtuar për ta vërtetuar në procedurë të vërtetën. Nuk ka pasur shkelje të nenit 7(2) të KPP-së.

Në pjesën ku mbrojtja pohon se ka pasur shkelje të nenit 253 të KPP-së, një pohim i tillë është i paqartë e edhe i pabazë.

Sa i përket prezumimit të pafajësie, kolegji nuk gjen shkelje të këtij parimit. Prezumimi i pafajësisë nuk nënkupton se një i pandehur nuk mund të shpallet fajtor. Parimi i mbron të pandehurit që të mos konsiderohen dhe trajtohen fajtor para se të merret aktgjykimi i formës së prerë. Nuk ka asnjë tregues në shkresat e lëndës se Gjykata Themelore do të kishte vepruar në këtë mënyrë. Trupi gjykues ka zhvilluar një gjykim të paanshëm dhe i ka dhënë një konsideratë të duhur propozimeve për prova njësoj si nga mbrojtja ashtu edhe nga prokuroria dhe i ka peshuar me kujdes provat dhe pohimet e të dy palëve. Kjo është e qartë nga aktgjykimi i kundërshtuar dhe arsyetimi i dhënë nga trupi gjykues aty.

Sa i përket parimit *in dubio pro reo*, kolegji thekson sërish se parimi është relevant vetëm kur gjykata përballet me dyshime lidhur me ekzistimin e fakteve përkatëse për lëndën ose zbatimin e dispozitave të ligjit penal. Gjykata e ka vërtetuar në mënyrë të duhur ekzistimin e një grupi terrorist **dhe** pjesëmarrjen e të pandehurve përkatës në te. Gjykata ka vërtetuar rolin udhëheqës në grup të V.J.t dhe aktivitetet terroriste të të gjithë të pandehurve përveç për J.Sh.n në formë të mbajtjes në posedim dhe kontroll të paautorizuar të armëve. Kolegji i apelit prandaj nuk ka pasur asnjë detyrim të zbatojë nenin 3(2) të KPP-së sepse i ka konsideruar të provuara faktet përtej dyshimit të arsyeshëm në bazë të provave të administruara gjatë gjykimit. Rrjedhimisht nuk ka pasur shkelje të ligjit procedural në këtë drejtim.

Kolegji i apelit përsëri thekson se, nëse janë apo nuk janë të drejta dhe të plota konkluzionet e Gjykatës Themelore, kjo është një çështje tjetër e cila do të vlerësohet në paragrafin e radhës së këtij aktgjykimi.

5. **Vërtetim i gabueshëm dhe jo i plotë i gjendjes faktike: neni 386 i KPPK-së**

Të gjithë parashtruesit e ankesave e kanë kundërshtuar vërtetimin e gjendjes faktike nga trupi gjykues.

5.1 Në ankesën e tij avokati mbrojtës i të pandehurit V.J. ka theksuar se veprimet e ndërmarra nga i akuzuari sikurse specifikohet në dispozitivin e aktgjykimit nuk kanë qenë të provuara me asnjë provë. Nuk ka prova për t'i vërtetuar elementet e veprës penale për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor. Prandaj në mungesë të provave lidhur me elementet e veprës penale, gjykata e ka kthyer gjendjen faktike në dëm të të akuzuarit. Në rastin e V.J.t, gjykata i ka konsideruar provat e transkriptimeve të bisedës telefonike, fotografitë, dëshmitarët të cilët kanë dëshmuar për gëzhojat e rimarra dhe dëshmitë e ekspertëve² të cilët vetëm kanë dëshmuar prej nga janë shkrepur plumbat. Armët gjoja të përdorura për të kryer veprat penale asnjëherë nuk janë gjetur. Pohimi i prokurorit në pikën 2 të aktakuzës se i pandehuri V.J. ishte udhëheqës i organizimit të grupit terrorist nuk ka qenë i provuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. V.J. ishte udhëheqës i subjektit politik të quajtur “Lëvizja për liri” e cila ishte marrë me zgjedhjen e çështjës së shqiptarëve me mjete politike në Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë.

5.2 Në ankesën e tij i pandehuri V.J. pohon se nuk ka prova të cilat qojnë në konkluzionin e gjyqtarit se i pandehuri ishte i detyruar me ide ekstreme. Ai më tej pohon se gjyqtari e ka vërtetuar gabimisht bisedën telefonike duke iu qasur asaj në mënyrë jo analitike dhe joprofesionale dhe vetëm duke u mbështetur në mendimin e prokurorit sikurse përshkruhet në aktakuzë. Biseda telefonike ka qenë miqësore dhe nuk ka pasur përmbajtje inkriminuese. Prandaj nuk ka shkelje të nenit 386 (1, 2, 3) të KPPK-së.

5.3 Avokati mbrojtës i të pandehurit S.J. pohon se grupi “Lëvizja për liri” nuk ka qenë grup terrorist sikurse pohohet nga gjykata. I pandehuri plotësisht e ka mohuar përfshirjen e tij të dhunshme për të zgjedhur çështjen e shqiptarëve në luginën e Preshevës. Akuzat janë bazuar vetëm në pohime pa ofruar prova konkrete për rastin.

5.4 Mbrojtësi i të pandehurit G.L. pohon se gjykata duhet të vërtetojë faktet vendimtare në mënyrë që t'i zbulojë plotësisht faktet relevante ligjore. Deklaratat e dëshmitarëve nuk ofrojnë veprime inkriminuese të të pandehurit G.L. Ai e mohon përfshirjen e G.L. në aktet e Dobrosinit. Vet i pandehuri e ka mohuar përfshirjen e tij dhe gjykata është dashur ta konfirmojë këtë fakt. Avokati mbrojtës pohon se në shkresat e lëndës nuk ka asnjë raport rreth lëndimeve të policit të Republikës së Serbisë por është konfirmuar se i pandehuri ishte përfshirë në kryerjen e lëndimeve. Gjikata nuk e ka ri-konstruktuar lëndën. Mbrojtësi pohon se me shqiptimin e një dënimi më të butë do të arrihej edhe qëllimi i tij (dënimit).

5.5 Avokati mbrojtës i të pandehurit G.Xh. paraqet se gjykata nuk i kishte paraqitur faktet në mënyrë të qartë dhe nuk e kishte vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse. Ai më tej paraqet se arsyetimi i aktgjykimit, në lidhje me këtë të pandehur, ishte bazuar vetëm në raportin e policisë lidhur me masat e fshehta/përgjimin e telekomunikimeve të cilat nuk sjellin dyshimin e arsyeshëm se i pandehuri i ka kryer veprat kriminale për të cilat është dënuar. Biseda e përgjuar në mes të G.Xh.t dhe V.J.t, e cila është cituar në arsyetimin e aktgjykimit nuk mund të provojë se G.kishte marrë pjesë në kryerjen e aktit kriminal. Gjikata e shkallës së parë nuk e ka provuar pjesëmarrjen e G. në sulmin e datës 28 qershor 2012. I pandehuri G.Xh. nuk ka sjellë asnjë pohim konkret në ankesën e parashtruar nga ai.

² Eksperti është propozuar nga prokurori.

5.6 Avokati mbrojtës i Q.R.t paraqet se aktgjykimi ishte bazuar vetëm në paragjykime. Biseda e përgjuar telefonike e të pandehurit Q. tregon se ai nuk kishte marrë pjesë në asnjë veprim i cili mund të cilësohet akt terrorist. Të gjeturat e gjykatës se Q. ishte përpjekur ta përfshijë kushëririn e tij në Lëvizjen për liri, është vetëm supozim.

5.7 Në ankesën e tij avokati mbrojtës i të pandehurit M. A. pohon se bisedat e përgjuara telefonike nuk janë vlerësuar siç duhet. Ai ishte arrestuar në afërsi të stacionit të autobusëve në Prishtinë ku ishte duke punuar dhe ishte vetëm e jo, siç është thënë, me V.J.n. Gjatë shqyrtimit gjyqësor asnjëri nga personat e akuzuar nuk e kanë përfshirë të pandehurin në ndonjë veprim inkriminues. V. dhe S.J. e edhe personat/vendasit e të pandehurit kanë konfirmuar se i pandehuri M.A. asnjëherë nuk ka qenë pjesëtar i “Lëvizjes për liri”. Po ashtu asnjëherë nuk janë vërtetuar pohimet se të pandehurit me veprimin e tyre i kanë detyruar pjesëtarët shqiptarë të policisë serbe që t’i lënë vendet e tyre të punës. Asnjëri nga ta nuk e ka lënë punën për shkak të veprimeve të ndërmarra nga i pandehuri. Përgjimet e telefonit nuk tregojnë për përgatitje të ndonjë sulmi të armatosur. Deklaratat e dëshmitarëve janë të parëndësishme sepse asnjëra nga to nuk i përshkruajnë veprimet ikriminuese të të pandehurit.

5.8 Në ankesën e tij avokati mbrojtës i të pandehurit S.S. pohon se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike lidhur me veprën penale të kryerjes së terrorizmit në kundërshtim me nenin 109 (1.10) nenin 110 (1) të KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 135 (1.10) dhe 136 (1) të KPRK-së dhe pjesëmarrjes në një grup terrorist në kundërshtim me nenin 113 (3) të KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 143 (2) të KPRK-së. Mbrojtja e ka kundërshtuar vërtetësinë e fotografive. Konkluzioni i gjykatës se fotografitë janë bërë pasditen e vonshme të datës 15 maj 2012 nuk është provuar me asnjë provë gjyqësore dhe të besueshme. Biseda telefonike nuk është vlerësuar siç duhet. Konkluzioni i gjykatës se i pandehuri ishte pjesëtar aktiv i grupit është i gabueshëm. Gjatë shqyrtimit gjyqësor më 19 gusht 2013 në mes tjerash, V.J. pohon se atij nuk i kujtohet ku dhe kur ishte bërë ajo foto me S.S.n. Gjatë procedurës paraprake i pandehuri S.J. pohon se ai nuk e ka njohur S.S.n. Ai e njuh atë vetëm prej kohës kur është ngritur aktakuza. Ai nuk është pjesëtar i Lëvizjes për liri. Mbrojtësi më tej i referohet deklaratës së vet M. A. dhe S.S.t duke pohuar se aktgjykimi mbështetet në gjendjen faktike të konfirmuar në kundërshtim me nenin 386 të KPP-së.

5.9 Në ankesën e tij avokati mbrojtës i të pandehurit E.M. pohon se në shqyrtimin gjyqësor, prokurori nuk ka arritur ta konfirmojë asnjë provë lidhur me veprat penale për të cilat i pandehuri është shpallur fajtor. Prokurori nuk ka arritur të sjell fakte lidhur me veprën penale të kryerjes së terrorizmit në bashkëkryerje në grup sepse ekzistenca e grupit më fjalë nuk është konfirmuar për shkak se të pandehurit nuk kanë asnjë lidhje tjetër mes vete përveç miqësisë nga universiteti. Fotografia e E.M.t është bërë rastësisht derisa ishte në shoqëri të S.J.t për në Preshevë. Ai u takua me disa persona të panjohur me uniforma dhe nga kureshtja ka kërkuar nga ta që të bëjnë fotografi me armët dhe uniformat e tyre. Avokati mbrojtësi parqet se ai nuk mund të shpallet fajtor sepse fotografia nuk është fakt. Fotografitë dhe përgjimet telefonike nuk janë të mjaftueshme për ta shpallur E.M.n fajtor për akt terrorist pasi që të njëjtat nuk shkojnë përtej dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e këtyre veprimeve kriminale. Nuk është e vërtetë se i pandehuri ka marrë pjesë në tri akte terroriste sikurse pohohet nga prokurori. Kjo nuk është konfirmuar në seancën e gjyqimit. Nuk ka pasur asnjë provë e as deklaratatë të dëshmitarëve për ta provuar se i pandehuri ka përdorur një

model të caktuar të armëve ose që ka marrë pjesë në ndonjë sulm ose për ndonjë plagë nga sulmi. Është e papranueshme dëshmia se policia serbe ishte plagosur gjatë sulmit në stacionin policor të Bujanovcit.

5.10 Në ankesën e tij avokati mbrojtës i të pandehurit A.Z. pohon se nuk ka prova për ta provuar se i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilat është shpallur fajtor. As aktakuza e as aktgjykimi nuk përmbajnë veprimet penale të ndërmarra nga i pandehuri. A.Z. nuk i njeh të pandehurit e tjerë përveç V.J.t të cilin e njeh nga universiteti. Ai dhe V.J. kanë biseduar vetëm lidhur me provimet. Kjo mund të konfirmohet edhe nga thirrja telefonike e datës 17 qershor 2012. Ai më pas pohon se i nuk ka bërë biseda telefonike e as nuk e ka shfrytëzuar internetin pasi që ka jetuar në një fshat ku nuk ka pasur rrjet. Gjatë bastisjes, policia e EULEX-it nuk ka gjetur asnjë armë. Ishte konfiskuar vetëm kompjuteri i vëllait të tij. Nuk është gjetur asgjë që do ta përfshinte atë. I pandehuri madje as nuk e ka ditur se ekziston grupi terrorist Lëvizja për liri. Avokati mbrojtës pohon se për tu njohur si organizatë terrorist, Lëvizja për liri duhet të gjendet në listën e organizatës së KB lidhur me grupet terroriste. I pandehuri asnjëherë nuk është akuzuar në Serbi, bile ai nuk e din as ku është kufiri. Grupi terrorist nuk mund të ekzistojë pasi që ata nuk e njohin njëri tjetrin. A. kurrë nuk i ka parë bashkë të pandehurit derisa është takuar me ta në seancën e gjyqimit. Nuk ka asnjë foto të A.Z.t me të pandehurit e tjerë.

5.11 Në ankesën e tij avokatja mbrojtëse e të pandehurit J.Sh. pohon se bisedat telefonike ishin të rastësishme dhe të paqarta. Edhe pse kanë biseduar, armët nuk kanë ekzistuar. Transaksioni prej 300 euro, çmimi i armës, kurrë nuk është bërë. Ajo më tej pohon se duhet të merret në konsideratë se nuk është gjetur asnjë armë e zjarrit përveç diku rreth 20 plumba të papërdorur e të ndryshkur nga koha e luftës, kurse i pandehuri është dënuar nga kapitulli lidhur me armët.

Vlerësimi i kolegjit

Para se të vlerësohen çështjet meritore të pohimeve të paraqitura nga palët, kolegji e konsideron të domosdoshme ta qartësojë standardin e shqyrtimit për ankesa lidhur me gjetjet faktike të zhvilluar nga trupi gjykues. Neni 386 i KPP-së përcakton kushtet e “vërtetimit të gabueshëm të gjendjes faktike” dhe “vërtetimin jo të plotë të gjendjes faktike”. Nga këto përkufizime është e qartë se nuk është e mjaftueshme për parashtruesin e ankesës të tregojë vetëm një gabim të supozuar të gjendjes faktike ose vërtetimin jo të plotë të gjendjes faktike të bërë nga trupi gjykues. Më saktë, kodi i procedurës penale kërkon që vërtetimi i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike të ndërlihet me një fakt vendimtar d.m.th. një fakt që është kritik për vendimin e marrë.³ Rrjedhimisht Gjykata e Apelit vetëm në instanca të tilla do ta kthejë vendimin e trupit gjykues për arsye faktike.

Është parim i përgjithshëm në procedurën e apelit që Gjykata e Apelit duhet patjetër të tregojë një dozë respekti ndaj gjetjes faktike të trupit gjykues për arsye se ky i fundit ka qenë në pozitë më të mirë për t'i vlerësuar provat në fjalë. Gjykata Supreme e Kosovës shpesh ka konsideruar se duhet patjetër *“ta respektojë vlerësimin e bërë nga trupi gjykues lidhur me besueshmërinë e dëshmitarëve të gjyqimit të cilët janë paraqitur personalisht para tyre dhe të cilët kanë dëshmuar personalisht para tyre. Nuk i shkon Gjykatës Supreme të Kosovës që të kalojë mbi vlerësimin e trupit gjykues lidhur me besueshmërinë e këtyre dëshmitarëve nëse nuk ka ndonjë bazë të shëndoshë për të bërë*

³ Shih po ashtu B. Petric në: komentimet e neneve të Ligjit jugosllav të procedurës penale, botimi i dytë i vitit 1986, neni 366, par. 3

diçka të tillë.” Standardi të cilin e ka aplikuar Gjykata Supreme ka qenë “*të mos preken gjetjet e gjykatës që e ka gjykuar lëndën nëse ndonjë gjykatë faktike nuk i ka pranuar provat mbi të cilat është mbështetur gjykata e cila e ka gjykuar lëndën, ose në rastet kur vlerësimi i saj ka qenë tërësisht i gabueshëm*” (Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 84/2009, 3 dhjetor 2009, para. 35; Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 2/2012, 24 shtator 2012 30). Qasja e Gjykatës Supreme e reflekton edhe parimin e procedurës së apelit – edhe pse me disa mospërputhje – është njëlloj edhe në sistemin anglosakson edhe atë kontinental e edhe në procedurën e ligjit penal ndërkombëtar.

Arsyeja e ankesës për të kundërshtuar faktet e vërtetuara doemos duhet ta sqarojë se cilat prova do të tregonin se një fakt i caktuar ka qenë i konsideruar i provuar ose jo i provuar dhe pse është ashtu. Ligji nuk ua pranon palëve të drejtën për një aktgjykim të dytë por të drejtën e rishqyrtimit të aktgjykimit. Nuk pritët nga Gjykata e Apelit që ta përsëris shqyrtimin e të gjitha provave sikurse aktgjykimi i mëparshëm të mos ekzistonte kurrë.

Në lëndën në fjalë është konfirmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat ata janë shpallur fajtor. Në shkresat e lëndës ekzistojnë prova të bollshme për të treguar përfshirjen e të pandehurve në aktivitete kriminale ashtu sikurse edhe akuzohen.

Lidhur me të pandehurin V.J., nga raporti i datës 21 qershor 2012 rezulton se janë zhvilluar një sërë bisedash të përgjuara telefonike nga të pandehurit V.J. dhe J.Sh. të cilat zbulojnë rolin të cilin i pandehuri V.J. e ka luajtur në organizimin e grupit terrorist të njohur si “Lëvizja për liri”. Ekzistojnë edhe biseda të tjera të përgjuara telefonike për ta vërtetuar rolin e tij organizativ të tilla si biseda e përgjuar telefonike e datës 13 qershor 2012 në orën 21:50 min në mes të Q.R.t dhe V.J.t. Më 07 qershor 2012 nga ora 12:26 deri në 13: 06 kishte një sërë thirrjesh nga G.Xh. te V.J.n kur kanë biseduar për uniformat gjermane. Biseda në mes të V.J.t dhe G.Xh.t tregon se V.J. e ka pasur fjalën e fundit lidhur me pjesëtarët individual në aktivitetet e ‘Lëvizjes për liri. Bisedat e tjera të përgjuara tregojnë se V.J. është njoftuar rreth iniciativave të grupit si dhe cilat pajisje nevojiten. Nga një bisedë e përgjuara telefonike po ashtu konfirmohet se V. ishte përgjegjës për furnizimin me armë dhe uniforma për grupin përfshirë këtu edhe J.Sh.n.

Kolegji i Gjykatës së Apelit pajtohet në tërësi me të gjeturat e gjykatës së shkallës së parë se të gjitha këto biseda të përgjuara telefonike e tregojnë rolin udhëheqës të V.J.t si lider të grupit terrorist “Lëvizja për liri”.

Nuk janë vetëm bisedat e përgjuara telefonike ato të cilat e konfirmojnë rolin udhëheqës të V.J.t, kjo është konfirmuar edhe gjatë marrjes në pyetje më 1 korrik 2012 dhe 18 shkurt 2013 kur ai ka deklaruar se është udhëheqës i “Lëvizjes për liri”. Gjithashtu ai ka pranuar se e ka nënshkruar komunikatën me të cilën e ka pranuar përgjegjësinë e “Lëvizjes për liri” për sulmin terrorist më 17 maj dhe 28 qershor 2012. Deklaratat e V.J.t janë konfirmuar edhe me prova vendimtare të konfiskuara gjatë bastisjes në banesën e V. dhe S.J.t më 1 qershor 2012.

Nga provat është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se V.J., G.Xh. dhe E.M. kanë kryer sulmin më 28 qershor 2012. Po këtë datë, rreth orës 04:00 të mëngjesit, është sulmuar me armë zjarri pika e kontrollit e policisë serbe në Dobrosin me ç’ rast është plagosur lehtë polici B. M. Të nesërmen, “Lëvizja për liri” e ka publikuar një komunikatë në internet për ta deklaruar përgjegjësinë për sulm. Kolegji vëren se i pandehuri V.J. e ka pranuar se ai e ka nënshkruar këtë komunikatë edhe pse ai e ka mohuar pjesëmarrjen. Në mbrëmjen para sulmit janë zhvilluar një sërë bisedash telefonike në mes të V.J.t, E.M.t dhe G.Xh.t lidhur me përgatitjen e këtij sulmi. Bisedat e përgjuara telefonike në

mënyrë të qartë tregojnë se të pandehurit po përgatiteshin për sulm. Në mesin e bisedave të përgjuara, është një bisedë më inkriminuese në mes të V. dhe G.Xh.t. Në këtë bisedë V. thotë se “policia kufitare vetëm sa shkuan lart ...e hoqën veturën sa më shpejt që munden dhe erdhën në Pograxhë”. G.Xh. e konfirmon duke thënë “në rregull”. Është krejtësisht çështje tjetër nëse përfshirja në këto sulme ka qenë e cilësuar siç duhet juridikisht edhe nga prokurori edhe nga Gjykata Themelore e që do të shtjellohet më tej nga Gjykata e Apelit

Ekzistojnë prova të mjaftueshme inkriminuese për të konfirmuar pjesëmarrjen e të pandehurit S.J. në grup terrorist. Provat e konfiskuara respektivisht fotografitë konfirmojë se i pandehuri S. Jashari bashkë me të pandehurit e tjerë morën pjesë në ekspedita të tjera më 18 mars, 28 prill, 1 dhe 6 maj 2012. Njëherazi është konfirmuar se i pandehuri S. J. e ka përpiluar komunikatën për publik lidhur me sulmin e datës 28 qershor 2012. Dokumenti origjinal i kësaj prove është gjetur në banesën e S. Jasharit. Provat e tjera të cilat tregojnë përfshirjen e të pandehurit S. J. në grup terrorist është ditari i tij elektronik dhe letra e konfiskuar gjatë bastisjes. Ditari tregon projektet e “Lëvizjes për liri” në një sërë rastesh për të mbledhur armatimi dhe veprime të tjera inkriminuese. I pandehuri S. J. ka marrë pjesë në sulmin e 7 tetor 2012 menjëherë pas lirimit nga arrestimi.

Nga bisedat e përgjuara telefonike po ashtu u vërtetua se më 7 shtator 2012 ishte sulmuar me armë zjarri pika e kontrollit të policisë serbe në Dobrosin. Bisedat telefonike janë bërë më 29 shtator 2012 në orën 01:03 të mëngjesit, kur G.L. e ka thirrur S.J.n. Ai i ka thënë Skenderit që të vijë të nesërmen sepse ai do ta “pjek një pulë”. Më 30 shtator 2012 S.e thërret E.M.n duke i thënë se ata nuk duhet të flasin shumë në telefon. Ka edhe biseda të tjera telefonike të zhvilluara në mes të pandehurve e të cilat tregojnë përfshirjen e tyre në sulme.

Për më tepër në dëshminë e tij të datës 16 tetor 2012, i pandehuri S.J. ka pranuar se e ka nënshkruar deklaratën e përgjegjësisë si *Gjorgji Shqiperia* dhe e ka publikuar në internet nga llogaria e postës së tij elektronike.

Përgjimet telefonike tregojnë përfshirjen e G.L.si pjesëtar aktiv i grupit terrorist “Lëvizja për liri”. Roli i tij ka qenë pjesëmarrja në blerjen e armëve. Roli i G.L. është përshkruar edhe në ditarin elektronik të S.J.t. Një bisedë e përgjuar telefonike në mes të G.L.dhe V.J.t tregon se ata kanë biseduar për “pulë të madhe me 30 zogj që ka kushtuar 300”. V. është përgjigjur se nuk ka të holla për te por thotë se “së pari shihe nëse punon”. Të pandehurit e kanë shfrytëzuar gjuhën e koduar gjatë bisedës së tyre telefonike me qëllim për ta fshehur të vërtetën. Për t’i përmbushur planet e “Lëvizjes për liri”, G.L. e njofton V. për mundësinë e blerjes së një Kalashnikovi AK47. Ekzistojnë prova të mjaftueshme për ta konfirmuar pjesëmarrjen e G.L.në aktivitete për të siguruar armë për “Lëvizjen për liri”.

Me provat e administruara gjatë seancave të gjyqimit, është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri A.Z. ishte pjesëtar aktiv i grupit “Lëvizja për liri”. provat e mbledhura gjatë hetimeve, tregojnë në mënyrë të qartë se ai ka marrë pjesë në dy ekspedita ushtarake gjatë 2012 e edhe në misione të tjera si pjesëtar i këtij grupi. është edhe një fotografi e gjetur në banesën e S.J.t e cila tregon A.Z.n dhe S.J.n duke bartur një AK 47 me UÇPMB. Po ashtu është provuar se A. Z. ka njohuri për vendndodhjen e armëve të grupit.

Pjesëtar tjetër aktiv i grupit është edhe E.M.. Ai e ka mohuar përfshirjen e tij në sulmin e 7 tetor 2012. Kjo dëshmi nuk konsiderohet e besueshme dhe në kundërshtim me provat kredibile të cilat tregojnë praninë e E.M.t në një vend të afërt prej nga është bërë sulmi e jo në shtëpi sikurse ai ka pohuar. Është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ai ka marrë pjesë në këtë sulm dhe në sulmin

e datës 27 qershor 2012. E. Musolli ka marrë pjesë në ekspeditën e 18 mars dhe 6 maj 2012 që është provuar nga një sërë fotografish të gjetura në kompjuterin personal i cili është konfiskuar në banesën e S.J.t.

Lidhur me të pandehurin G.Xh., ekzistojnë prova të bollshme për ta konfirmuar rolin e tij aktiv në grup. Ai ishte në kontakt të afërt telefonik me V.J.n. Raporti i hetuesit CTU i datës 21 qershor 2012 e bën të qartë, se në një sërë bisedash telefonike G.Xh. e ka njoftuar V.J.n lidhur me furnizimin e me së paku 6 uniforma gjermane për grupin. Më 18 qershor 2012 G.Xh. e ka thirrur V.J.n për ta biseduar aktivitetin dhe planin strategjik të grupit lidhur me sulmin e armatosur. Kur ka ndodhur sulmi i dytë në Dobrosin më 27 qershor 2012, V. e thërret G.Xh.n duke i kërkuar huazimin e veturës së E. në mënyrë që ta aranzhojnë transportin e pjesëtarëve të grupit. Fotografitë, ditari i shkruar dhe elektronik i S.J.t e konfirmojnë se G.Xh. ishte përfshirë në furnizimin e grupit me armë. Është vërtetuar se G.Xh. ka marrë pjesë po ashtu në dy ekspedita të stilit ushtarakë bashkë me V.J.n, S.J.n, Q.R.n, M.A.n, S.S.n, A.Z.n dhe G.L. më 15 maj dhe 14/15 qershor 2012.

Sa i përket të pandehurit Q.R., është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ai ishte pjesëtar i grupit terrorist “Lëvizja për liri”. Ekzistojnë një sërë bisedash telefonike në mes të atij dhe V.J.t që flasin për sulme. Është edhe një listë fjalësh të koduara të përdorura shpesh në mesin e pjesëtarëve të grupit të gjetura në xhepin e Q.R.t. Ekzistojnë edhe një sërë fotografish të cilat tregojnë Q. Rexhajn duke pozuar me Kalashnikov.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se M.A. ishte pjesëtar aktiv i grupit terrorist “Lëvizja për liri”. Ekzistojnë edhe biseda telefonike në mes të tij dhe S.J.t e V.J.t. Po ashtu ekzistojnë prova të siguruara nga urdhëresa e gjykatës për vëzhgim të cilat tregojnë së bashku M.A.n dhe V.J. menjëherë pas sulmit të datës 28 qershor 2012. Gjatë këtij vëzhgimi V. J. imiton veprimet e shkrepjes me gjeeste. Ekzistojnë edhe prova të gjetura në ditarin elektronik të S.J.t të cilat e përfshijnë të pandehurin M.A. në furnizimin me armë të grupit.

Provat në shkresat e lëndës tregojnë se i pandehuri S. S. ishte pjesëtar i grupit. Ai është mbledhur bashkë me pjesëtarët e tjerë të grupit për të pozuar me armë të rënda. Ditari elektronik i S.J.t tregon bisedën në mes të tij dhe S.S.t dhe një shoku tjetër për sulmin. Gjithashtu nga provat është vërtetuar se S.S. ka marrë pjesë në ekspeditën e majit 2012 dhe në mes të qershorit 2012.

Lidhur me të pandehurin J.Sh., provat në shkresat e lëndës provojnë përtej dyshimit të arsyeshëm se ai ka kryer veprën penale të furnizimit dhe shitjes së paautorizuar të armëve dhe veprën penale të përdorimit të armëve. Bisedat e analizuara telefonike tregojnë diskutimin e J.Sh.t me Muhadin Kadriun rreth shitjes së armëve. Lidhur me veprën penale të përdorimit të armëve, është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri J.Sh. ka poseduar dhe shkrepur armë të zjarrit.

Konkluzion

Sipas të gjitha provave të mbledhura gjatë hetimeve dhe të administruara në shqyrtimin gjyqësor, kolegji i Gjykatës së Apelit pajtohet me të gjeturat e gjykatës së shkallës së parë se është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor duke pasur parasysh vlerën e fuqishme provuese të këtyre provave dhe gjetjeve të cilat bazohen në prova.

Shkelje të pohuara të ligjit penale

Shumica e të pandehurve pohojnë për gabimet e Gjykatës Themelore në zbatimin e ligjit penal. Në parim ato mundë të përmblihen me zbatimin e gabueshëm të ligjit që përcakton krimin e kryerjes së terrorizmit dhe organizimin / marrjen pjesë / në grup terrorist.

Avokati mbrojtës i S.S.t më konkretisht parasheh se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike lidhur me veprën penale të kryerjes së terrorizmit në kundërshtim me nenin 109 (1.10) nenin 110 (1) të KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 135 (1.10) dhe 136 (1) të KPRK-së dhe pjesëmarrjen në një grup terrorist, në kundërshtim me nenin 113 (3) të KPRK-së aktualisht e dënueshme me nenin 143 (2) të KPRK-së. Në lëndën në fjalë, edhe pse faktet relevante kanë ndodhur derisa ishte në fuqi KPK-ja 2003, do të zbatohet kodi i ri penal i Republikës së Kosovës si ligj më i favorshëm (parimi i paraparë me nenin. 3(2) *po aty*. Kryerja e terrorizmit është e dënueshme me nenin 136 të KPRK-së por në nenin 135 *po aty* janë përmendur hipoteza të ndryshme të mundshme të veprës penale. Të gjitha veprimet e përmendura nga pika 1.1 deri në pikën 1.19 (përfshirë këto nën pikën 1.10, të cilat janë të rëndësishme në këtë rast) të nenit 135 përbëjnë vepra të vetme penale por qëllimi i veçantë me të cilin ato janë kryer i cilëson ato si terrorizëm e që bëhet kur këto veprime kryhen me qëllim të - kur përdorim gjuhën e ligjit: *“të frikësojë seriozisht popullatën, ta detyrojë padrejtësisht një subjekt publik, qeverinë ose një organizatë ndërkombëtare për ta bërë ose të mos e bërë ndonjë veprim apo të destabilizojë ose shkatërrojë seriozisht strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të Republikës së Kosovës, të ndonjë shteti tjetër, ose një organizatë ndërkombëtare”*. Në lëndën në fjalë qëllimi i veçantë i nëntë të pandehurve të parë ka qenë që *“padrejtësisht ta detyrojnë Qeverinë e Republikës së Serbisë për t’i pushuar aktivitetet policore në regjionin e Bujanovcit, padrejtësisht t’i detyrojë pjesëtarët shqiptarë të policisë serbe që t’i lëshojnë vendet e tyre të punës dhe padrejtësisht ta detyrojë ‘bashkësinë ndërkombëtare’ të dërgojë forca paqeruajtëse në rajon”*. Do të ishte naive për të gjithë e lëre më për gjykatën për t’u besuar pohimeve sikurse ajo e thënë nga njëri prej të pandehurve se vetëm rastësisht ata i kanë takuar disa njerëz të panjohur dhe nga kureshtja kanë bërë fotografi me armë të veta ose që vërtetë në telefon ata bisedonin për zogj e jo për armë ose që shpalljet e bëra nga disa prej tyre nëpërmes rrjeteve sociale nuk kishin të bënin asgjë me terrorizmin. Në këtë aspekt, Gjykata e Apelit nuk ka gjetur asnjë kundërshtim në përcaktimin e veprimeve të nëntë të pandehurve të parë si terrorizëm në hipotezën e nenit 135 (1.10) *po aty*.

Pohimi tjetër për shkelje të ligjit penal është ngritur nga avokati mbrojtës i të pandehurit G.L. Në ankesën e tij ai paraqet se gjykata nuk i është referuar nenit 31 të KP-së kur ka deklaruar se i pandehuri ka kryer veprën penale në bashkëkryerje me bashkëpunëtorë të tjerë në grup terrorist. Ai pohon se me mos zbatimin e këtij neni, gjykata e shkallës së parë i ka shkelur dispozitat e KP-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit pajtohet se dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar nuk i referohet nenit 31 të KP-së kur sqaron kryerjen e veprës penale të kryerjes së terrorizmit në bashkëkryerje. Kolegji vëren se arsyetimi i aktgjykimit të kundërshtuar shpjegon në mënyrë të qartë aktivitetin kriminal të të pandehurve i kryer në bashkëkryerje edhe pse dispozitivi i aktgjykimit nuk e përmend të njëjtën në dispozitiv në nen të veçantë.

Neni 31 i KP-së parasheh që:

“Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.”

Gjykata e shkallës së parë vërtet ka vepruar sikurse përshkruhet me këtë nen duke e dënuar secilin të pandehur në përputhje me rrethanat respektivisht duke e dënuar secilin të pandehur sipas kontributit individual në veprat penale të kryera në bashkëkryerje. Nuk shkon asgjë në dëm të të pandehurve e as në dobi të tyre nëse në dispozitiv shfaqet neni “31” përderisa elementet e veprës penale të parapara në këtë nen mbeten të vlefshme në arsyetimin e aktgjykimit. Fakti se të pandehurit kanë vepruar në bashkëkryerje është shpjeguar gjerësisht më sipër.

Pohim tjetër që do të shtjellohet është ai në ankesën e avokatit mbrojtës Destan Rukiqi e parashtruar në emër të të pandehurit S.S.. Në ankesën e tij ai pohon se vepra penale e kryerjes së terrorizmit përfshihet në Ligjin për amnisti me numër. 04/L-209.

Lidhur me këtë kolegji i Gjykatës së Apelit i refuzon pohimet e mbrojtësit për shkak të interpretimit të tij të gabueshëm të Ligjit mbi amnisti. Avokati mbrojtës i referohet:

1. Neni 1.1.10. të Ligjit për amnisti nr. 04/L-209: Mbajtja e paautorizuar në pronësi, në posedim dhe në kontroll e armëve (neni 374);
2. Neni 1.2.5. të Ligjit për amnisti nr. 04/L-209: Mbajtja e paautorizuar në pronësi, në posedim dhe në kontroll e armëve (neni 328, paragrafi 2.); dhe mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim dhe në përdorim të armëve nëse ai ose ajo nuk është mbajtës i autorizuar i kartelës valide të armës”, (neni 8.6 lidhur me nenin 8.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/7 të datës 21 shkurt 2001, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.2003/7).

Kolegji vëren se neni 1.1.10 i referohet mbajtjes së paautorizuar në pronësi, në posedim dhe në kontroll të armëve sikurse parashihet me nenin 374 të Kodit të ri Penal të Kosovës dhe zbatohet vetëm kur i pandehuri shpallet fajtor dhe dënohet për vepër penale në përputhje me këtë nen 374 e jo kur shpallet fajtor për kryerje të terrorizmit në hipotezën e nenit 136 (1) lidhur me nenin 135 (1.10), e që është përvetësimi mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose përdorimi i paautorizuar i armëve, me dashje, sikurse parashihet me nenin 135 (1). E njëjta vlen edhe për nenin 1.2.5. të Ligjit për amnisti nr. 04/L-209: mbajtjes së paautorizuar në pronësi, në posedim dhe në kontroll të armëve e zbatueshme për rastet kur i pandehuri shpallet fajtor për vepër penale sipas nenit 328, paragrafi 2 të Kodit të vjetër Penal të Kosovës. Prandaj kolegji e refuzon këtë pohim si të pabazë.

6. Vendimi mbi dënimin

Në ankesat e tyre mbrojtësit i kundërshtojnë sanksionet e shqiptuara penale.

Kur e ka përcaktuar dënimin ndaj të akuzuarve, gjykata e shkallës së parë ka pasur në konsideratë mënyrën e kryerjes së veprës penale. Përveç kësaj gjykata e shkallës së parë i ka specifikuar edhe rrethanat e tjera rënduese dhe lehtësuese për secilin të akuzuar:

- Sa i përket të akuzuarit V.J., gjykata e shkallës së parë i ka konsideruar si rrethana

lehtësuese moshën e tij të re dhe të kaluarën e tij të pastër penale. Si rrethana rënduese gjykata e ka konsideruar qasjen e lartë politike dhe vendosmërinë në arritjen e qëllimeve; mosrespektimin e zbatimit të ligjit në kuptim se ai ishte i gatshëm të shkatërrojë ose destabilizojë strukturën e brishtë politike të Kosovës duke filluar konflikt ushtarak në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë duke nisur luftë guerile; rolin udhëheqës dhe përjashtimor të cilin ai e ka luajtur në grup; pjesëmarrjen në sulmin terrorist në policinë kufitare të Serbisë në Dobrosin më 28 qershor 2012.

- Sa i përket të pandehurit S.J., gjykata e shkallës së parë i ka konsideruar si rrethana lehtësuese moshën e tij të re dhe të kaluarën e tij të pastër penale. Si rrethana rënduese gjykata e ka konsideruar qasjen e lartë politike dhe vendosmërinë në arritjen e qëllimeve; mosrespektimin e zbatimit të ligjit në kuptim se ai ishte i gatshëm të shkatërrojë ose destabilizojë strukturën e brishtë politike të Kosovës duke filluar konflikt ushtarak në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë duke nisur luftë guerile; rolin udhëheqës dhe përjashtimor të cilin ai e ka luajtur në grup; pjesëmarrjen në sulmin terrorist në policinë kufitare të Serbisë në Dobrosin më 7 tetor 2012.
- Sa i përket të pandehurit G.L., gjykata e shkallës së parë i ka konsideruar si rrethana lehtësuese moshën e tij të re dhe të kaluarën e tij të pastër penale. Si rrethana rënduese gjykata e ka konsideruar qasjen e lartë politike dhe vendosmërinë në arritjen e qëllimeve; mosrespektimin e zbatimit të ligjit në kuptim se ai ishte i gatshëm të shkatërrojë ose destabilizojë strukturën e brishtë politike të Kosovës duke filluar konflikt ushtarak në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë duke nisur luftë guerile.
- Sa i përket të pandehurit G.Xh., gjykata e shkallës së parë i ka konsideruar si rrethana lehtësuese moshën e tij të re dhe të kaluarën e tij të pastër penale. Si rrethana rënduese gjykata e ka konsideruar qasjen e lartë politike dhe vendosmërinë në arritjen e qëllimeve; mosrespektimin e zbatimit të ligjit në kuptim se ai ishte i gatshëm të shkatërrojë ose destabilizojë strukturën e brishtë politike të Kosovës duke filluar konflikt ushtarak në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë duke nisur luftë guerile; rolin udhëheqës dhe përjashtimor të cilin ai e ka luajtur në grup; pjesëmarrjen në sulmin terrorist në policinë kufitare të Serbisë në Dobrosin më 28 qershor 2012.
- Sa i përket të pandehurit Q.R., gjykata e shkallës së parë i ka konsideruar si rrethana lehtësuese moshën e tij të re dhe të kaluarën e tij të pastër penale. Si rrethana rënduese gjykata e ka konsideruar qasjen e lartë politike dhe vendosmërinë në arritjen e qëllimeve; mosrespektimin e zbatimit të ligjit në kuptim se ai ishte i gatshëm të shkatërrojë ose destabilizojë strukturën e brishtë politike të Kosovës duke filluar konflikt ushtarak në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë duke nisur luftë guerile;
- Sa i përket të pandehurit M.A., gjykata e shkallës së parë i ka konsideruar si rrethana lehtësuese moshën e tij të re dhe të kaluarën e tij të pastër penale. Si rrethana rënduese gjykata e ka konsideruar qasjen e lartë politike dhe vendosmërinë në arritjen e qëllimeve; mosrespektimin e zbatimit të ligjit në kuptim se ai ishte i gatshëm të shkatërrojë ose destabilizojë strukturën e brishtë politike të Kosovës duke filluar konflikt ushtarak në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë duke nisur luftë guerile;

- Sa i përket të pandehurit S.S., gjykata e shkallës së parë i ka konsideruar si rrethana lehtësuese moshën e tij të re dhe të kaluarën e tij të pastër penale. Si rrethana rënduese gjykata e ka konsideruar qasjen e lartë politike dhe vendosmërinë në arritjen e qëllimeve; mosrespektimin e zbatimit të ligjit në kuptim se ai ishte i gatshëm të shkatërrojë ose destabilizojë strukturën e brishtë politike të Kosovës duke filluar konflikt ushtarak në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë duke nisur luftë guerile;
- Sa i përket të pandehurit E.M., gjykata e shkallës së parë i ka konsideruar si rrethana lehtësuese moshën e tij të re dhe të kaluarën e tij të pastër penale. Si rrethana rënduese gjykata e ka konsideruar qasjen e lartë politike dhe vendosmërinë në arritjen e qëllimeve; mosrespektimin e zbatimit të ligjit në kuptim se ai ishte i gatshëm të shkatërrojë ose destabilizojë strukturën e brishtë politike të Kosovës duke filluar konflikt ushtarak në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë duke nisur luftë guerile; rolin udhëheqës dhe përjashtimor të cilin ai e ka luajtur në grup; pjesëmarrjen në sulmin terrorist në policin kufitare të Serbisë në Dobrosin më 7 tetor 2012.
- Sa i përket të pandehurit A.Z., gjykata e shkallës së parë i ka konsideruar si rrethana lehtësuese moshën e tij të re dhe të kaluarën e tij të pastër penale. Si rrethana rënduese gjykata e ka konsideruar qasjen e lartë politike dhe vendosmërinë në arritjen e qëllimeve; mosrespektimin e zbatimit të ligjit në kuptim se ai ishte i gatshëm të shkatërrojë ose destabilizojë strukturën e brishtë politike të Kosovës duke filluar konflikt ushtarak në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë duke nisur luftë guerile;
- Sa i përket të pandehurit J.Sh., gjykata e shkallës së parë i ka konsideruar si rrethana lehtësuese moshën e tij të re dhe të kaluarën e tij të pastër penale. Si rrethana rënduese gjykata i ka konsideruar vendosmërinë për të përfutur të ardhura të kundërligjshme nga shitja e armëve vdekjeprurëse dhe mosrespektimin e jetës së njeriut duke pasur parasysht se armët mundë të përdorën për t'i dëmtuar rëndë njerëzit dhe për t'i privuar ata nga jeta.

Vlerësimi i kolegjit të Gjykatës së Apelit

Kolegji i Gjykatës së Apelit plotësisht pajtohet me vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me rrethanat lehtësuese dhe rënduese të të pandehurve G.L., M.A., S.S., A.Z. dhe J.Sh..

Lidhur me të pandehurit V.J., S.J., G.Xh. dhe E.M., kolegji i Gjykatës së Apelit gjen mospërputhje në vlerësimin e rrethanave rënduese, pavarësisht pretendimeve të ngritura nga ana e avokatëve mbrojtës

Respektivisht dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar, lidhur me të pandehurin V.J. përmban:

“...ka marrë pjesë në një sulm që dëmtoi kontenierin e policisë kufitare serbe në Bujanovc dhe i shkaktoi policit serb B.M.lëndime të lehta trupore duke shtënë me armë të ndryshme, që të gjitha në posedim dhe përdorim të kundërligjshëm, me numër të pacaktuar të fishekëve (sido që të jetë, më shumë se 100) në bashkëkryerje me G.Xh.n dhe E.M.n; sulmi ka ndodhur në Dobrosin më 28 qershor 2012 rreth orës 04:00 ...”

Lidhur me të pandehurin S.J., dispozitivi përmban:

“...ka marrë pjesë në një sulm që dëmtoi kontenierin e policisë kufitare serbe në Bujanovc duke shtënë me armë të ndryshme, që të gjitha në posedim dhe përdorim të kundërligjshëm, një numër të pacaktuar të fishekëve me kalibër të ndryshëm e në bashkëpunim me E.M.n dhe një numër të paidentifikuar të kryerësve të tjerë. Sulmi ka ndodhur në (komuna e Gjilanit)⁴ më 7 tetor 2012 rreth orës 21:35.

Lidhur me të pandehurin G.Xh., dispozitivi përmban:

“...ka marrë pjesë në një sulm që dëmtoi kontenierin e policisë kufitare serbe në Bujanovc dhe i shkaktoi policit serb B.M.lëndime të lehta trupore duke shtënë me armë të ndryshme, që të gjitha në posedim dhe përdorim të kundërligjshëm, me numër të pacaktuar të fishekëve (sido që të jetë, më shumë se 100) në bashkëkryerje me V.J.n dhe E.M.n në Dobrosin më 28 qershor 2012 rreth orës 04:00 ...”

Dhe në lidhje me të pandehurin E.M., dispozitivi përmban:

“...ka marrë pjesë në një sulm që dëmtoi kontenierin e policisë kufitare serbe në Bujanovc dhe i shkaktoi policit serb B.M.lëndime të lehta trupore duke shtënë me armë të ndryshme, që të gjitha në posedim dhe përdorim të kundërligjshëm, një numër të pacaktuar të fishekëve me kalibër të ndryshëm (sido që të jetë, më shumë se 100) në bashkëkryerje me V.J.n dhe G.Xh.n në Dobrosin (komuna e Gjilanit) më 28 qershor 2012 rreth orës 04:00; ...” sepse ka marrë pjesë në një sulm që dëmtoi kontenierin e policisë kufitare serbe në Bujanovc duke shtënë me armë të ndryshme, që të gjitha në posedim dhe përdorim të kundërligjshëm, një numër të pacaktuar të fishekëve me kalibër të ndryshëm e në bashkëpunim me S.J.n dhe një numër të paidentifikuar të kryerësve të tjerë në Dobrosin (komuna e Gjilanit) më 7 tetor rreth orës 21:35...’

Sikurse u pa më sipër, përshkrimi i gjendjes faktike në pjesën e përmendur më lartë të dispozitivit përmban elemente të veprave të ndryshme penale. Faktet e më sipërme duhet të ishin kualifikuar siç duhet si dy akte të ndryshme të kryerjes së terrorizmit, të kryera në bashkim real, njëri veprim i ndërlidhur me posedim dhe përdorim të armëve sipas nenit 135 (1.10) dhe veprimi tjetër i ndërlidhur me sulmin/sulmet, ky i fundit një krim/e/ tjetër dhe jo pjesë e rrethanave faktike të krimit sipas nenit 135 (1.10). Prokurori nuk ka arritur që juridikisht ta përcaktojë aktakuzën në përputhshmëri me nenin 241 (1.4) . Gjykata e shkallës së parë nuk e ka ndrequr këtë gabim sepse kjo ka qenë e mundur sipas nenit 360 (2) të KPP-së. Në vend se të jap një cilësim të duhur juridik të sulmit / sulmeve / terroriste dhe pastaj ose t’i dënoj ose t’i lirojë të katër të pandehurit në fjalë (V.J., S.J., G.Xh. dhe E.M.) për atë krim / krime/ të veçantë, gjykata e shkallës së parë e ka shfrytëzuar këtë fakt / fakte/ si rrethanë/ rrethana/ rënduese, pra e ka përcaktuar dënimin në dëm të të pandehurve. Do të ishte një spekulim i kulluar për ta shtjelluar nëse të pandehurit në fjalë do të kishin qenë të dënuar ose të liruar po që se do të ishin akuzuar në mënyrë të duhur sepse çdo ndryshim në këtë drejtim do të mund të ishte bërë vetëm në nivelin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit nuk është në pozitë për ta korrigjuar gabimin e bërë në aktakuzë dhe/ose në gjykatën e shkallës së parë e që mund të përfundojë me cenim të kufizimit të *reformatio in peius*. Megjithatë Gjykata e Apelit është e detyruar ta korrigjojë lajthimin juridik i cili ka qar në dënim të rëndë në bazë të fakteve të cilat nuk ishin cilësuar siç duhet nga prokurori dhe gjykata e shkallës së parë (argumenti pas nenit 394 (1.4) të KPPK-së. Për aq sa këta katër të pandehur nuk ishin akuzuar

si duhet për sulm / sulme/ dhe ata as nuk u liruan as nuk u dënuan, ata nuk mund të kishin qenë të dënuar me dënime më të larta për kryerje të terrorizmit në formën e posedimit dhe përdorimit të armëve për shkak të këtyre sulmeve / sulmit/ të njëjta. Kjo e fundit përbën krim / krime/ të ndarë e jo rrethanë / rrethanat/ rënduese. Prandaj kolegji i Gjykatës së Apelit duke vepruar *ex officio*, e ka ndryshuar dispozitivin duke e hequr paragrafin e përshkruar më sipër lidhur me të pandehurit V.J., S.J., G.Xh. dhe E.M. dhe duke e shqiptuar dënimin të përcaktuar në dispozitiv sa u përket këtyre të pandehurve dhe atë me sa vijon:

- Kolegji njëzëri e ka dënuar të pandehurin V.J. me 5 (pesë) vjet burgim për veprën penale të kryerjes së terrorizmit dhe me 7 (shtatë) vjet burgim për veprën penale të organizimit të grupit terrorist. Kolegji njëzëri u pajtua që dënimi i arsyeshëm unik do të jetë 8 (tetë) vjet burgim. Pjesa tjetër e aktgjykimit të kundërshtuar sa i përket gjobës prej 1000 (një mijë) euro në lidhje me të pandehurin V.J. mbetet e pandryshuar;
- Kolegji njëzëri e ka dënuar të pandehurin S.J. me 5 (pesë) vjet burgim për veprën penale të kryerjes së terrorizmit. Kolegji në shumicë u pajtua për dënim me 4 (katër) vjet burgim sikurse është paraparë nga gjykata e shkallës së parë për veprën penale të pjesëmarrjes në një grup terrorist. Me shumicë votash kolegji ka vendosur që dënimi i arsyeshëm unik do të jetë 6 vjet e 6 muaj burgim.
- Kolegji njëzëri e ka dënuar të pandehurin G.Xh. me 5 (pesë) vjet burgim për veprën penale të kryerjes së terrorizmit. Kolegji në shumicë u pajtua për dënim me 2 (dy) vjet burgim sikurse është paraparë nga gjykata e shkallës së parë për veprën penale të pjesëmarrjes në një grup terrorist. Me shumicë votash kolegji ka vendosur që dënimi i arsyeshëm unik do të jetë 5 vjet e 6 muaj burgim.
- Kolegji njëzëri e ka dënuar të pandehurin E.M. me 5 (pesë) vjet burgim për veprën penale të kryerjes së terrorizmit. Kolegji në shumicë u pajtua për dënim me 2 (dy) vjet burgim sikurse është paraparë nga gjykata e shkallës së parë për veprën penale të pjesëmarrjes në një grup terrorist. Me shumicë votash kolegji ka vendosur që dënimi i arsyeshëm unik do të jetë 5 vjet e 6 muaj burgim.

Në këtë drejtim, kolegji i Gjykatës së Apelit duke e shqyrtuar aktgjykimin *ex officio* sipas nenit 394 (1.4) të KPPK-së lidhur me nenin 385 (1.4) *po aty* nenin 365 (1.2) *po aty* ka nxjerr konkluzionin se ligji penal d.m.th. parimi i ligjshmërisë është cenuar - neni 2 (3 - fjalia e parë) të KPRK-së (parimi i ligjshmërisë). Ligji parashikon se përkufizimi i një veprë penale duhet gjithmonë të interpretohet në mënyrë të rreptë dhe në rast paqartësie duhet të interpretohet medoemos në favor të të pandehurit. Në rastin në fjalë, gjendja faktike është përfshirë nën një përkufizim ligjor i cili nuk përkon me faktet. Mbi të gjitha, të njëjtat fakte më pas janë shfrytëzuar si rrethana rënduese e që është shkelje e vet ligjit penal (neni 74(2) i KPRK-së, i cili përmban një listë të gjerë të rrethanave rënduese) . Sikurse u tha më sipër elementet e një krimi nuk përbëjnë rrethanë rënduese të një krimi tjetër përveç nëse me ligj parashikohet ndryshe (për shembull kur një veprë penale është kryer si pjesë e aktiviteteve të një grupi të organizuar kriminal – neni 74 (2.11), i cili është përjashtim dhe jo relevant për lëndën në fjalë).

Lidhur me të pandehurin Q.R., kolegji i Gjykatës së Apelit e ka pranuar ankesën e parashtruar nga avokati mbrojtës vetëm në pjesë duke pasur parasysh pohimet e sjella për vendimin mbi dënimin. Kolegji konsideron se ekzistojnë kushtet për lehtësim të veçantë të dënimit siç parashihet me nenin

75 (1.2) të KPK-së lidhur me të pandehurin Q.R.. Kolegji konsideron se i pandehuri Q.R., në kohën e kryerjes së veprës penale para kryerjes së krimeve sapo i kishte mbushur 19 vjet. Në bazë të ri-vlerësimit të rrethanave rënduese dhe lehtësuese, kolegji i Gjykatës së Apelit njëzëri ka shqiptuar dënimin prej 3 (tre) vjet burgim për veprën penale të kryerjes së terrorizmit. Kolegji në shumicë është pajtuar për dënimin prej 2 (dy vjet) burgim sikurse është paraparë nga gjykata e shkallës së parë për veprën penale të pjesëmarrjes në grup terrorist. Me shumicë votash kolegji ka vendosur se dënimi i arsyeshëm unik do të jetë 4 vjet burgim.

Gjykata e Apelit konsideron se dënimet e shqiptuara nga kolegji i Gjykatës Themelore ndaj të pandehurve V.J., S.J., G.Xh., E.M. dhe Q.R. janë në përputhje me intensitetin e vlerës së mbrojtur, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve si kryerës të veprave penale. Sipas nenit 73 (2) të KPK-së dënimi doemos duhet të jetë proporcional me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryerësit. Gjykata a Apelit konsideron se ky dënim do ta përmbush qëllimin e dënimin sikurse parashihet me nenin 41 të KPK-së.

Konkluzionet e tjera të gjykatës së shkallës së parë në raport me të pandehurit G.L., M.A., S.S., A.Z. dhe J.Sh. janë konkluzione të drejta dhe Gjykata e Apelit i ka pasur parasysh kur i ka caktuar dënimet. Për këtë arsye, pjesa e aktgjykimit të kundërshtuar lidhur me këta të pandehur mbetet e pandryshuar.

Çështjet e tjera

Pasi që i pandehuri J.Sh. ishte dënuar për veprën penale të furnizimit dhe shitjes së paautorizuar të armëve me burgim prej 2 (dy) vjetësh, dhe vepra penale e përdorimit të armëve me burgimin prej 1 (një) viti, me dënimin unik prej 2 (dy) vjetësh e 2 (dy) muajsh, kolegji i Gjykatës së Apelit e ka vlerësuar kohën e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak për të pandehurin J.Sh. nga data e arrestimit të tij më 13 shkurt 2013, deri në datën e këshillimit të parë të kolegjit të Gjykatës së Apelit më 17 prill 2015, duke konstatuar se dënimi unik prej 2 (dy) vjetësh e 2 (dy) muajsh burgim i caktuar me aktgjykimin PKR nr. 53/13 të Gjykatës Themelore të Gjilanit, i datës 16 tetor 2013, tashmë është vuajtur.

Duke vepruar në përputhje me nenin 173 (3) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), dhe me nenin 183 (7), lidhur me nenin 367 (6) dhe (7) të KPPK-së, kolegji i Gjykatës së Apelit e ka hequr masën e arrestit shtëpiak ndaj të pandehurit J.Sh. menjëherë pas marrjes së aktvendimit të datës 17 prill 2015.

Shpenzimet e procedurës penale për të gjithë të pandehurit do të paguhet nga buxheti.

Siç u theksua më lart, në bazë të nenit 389 të KPP-së, Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv.

As stated above, pursuant to Article 389 of the CPC, the Court of Appeals decided as in the enacting clause.

Aktgjykimi është përpiluar në gjuhën angleze. Aktgjykimi i arsyetuar është kryer më 1 korrik 2015.

Kryetarja e kolegjit

Elka Filcheva-Ermenkova, gjyqtare e EULEX-it

Anëtarët e kolegjit

Fllanza Kadiu, gjyqtare kosovare

Willem Brouwer, gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtëse

Vjollca Kroçi - Gërxhaliu, këshilltare ligjore e EULEX-it

GJYKATA E APELIT

PAKR 145/2014

